	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	ver. 1.2	faqe 1 nga 144
Departamenti: Financiar dhe i Thesarit		Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik

OPERATOR SISTEMI TRANSMISIONI DHE TREGU KOSTT sh.a
TRANSMISSION SYSTEM AND MARKET OPERATOR KOSTT J.S.C
OPERATOR SISTEMA PRENOSA I TRŽIŠTA KOSTT d.d

Nr. 833/1 Dt. 08 04 2024
PRISHTINË-A

Raporti Vjetor 2023

Operatori i Sistemit Transmisionit dhe Tregut

KOSTT sh.a

Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e 151/24 të datës 7 mars 2024 miratoi Raportin Vjetor për vitin 2023

Vendimi 240307-II/6

Bordi i Drejtorëve në bazë të Nenit 31.3 të Ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe Nenit 14.2.2.11.2 të Statutit të Shoqërisë Aksionare KOSTT, njëzëri miratoi Raportin Vjetor për vitin 2023, si dhe në mbledhjen 151.1/24 të datës 8 prill 2024 me shumicë votash miratoi Ndryshim Plotësimet në Raportin Vjetor për vitin 2023.¹

	Përgatiti	Kontrolloi	Aprovoi
Emri Mbiemri	Nebih Haziri Zyrtar Kryesor për Financa dhe Trezor	Evetar Zeqiri Kryeshef Ekzekutiv	Bordi i Drejtorëve Jeton Mehmeti Kryesues i BD
Nënshkrimi			



¹ Vendim240408 i dt.08.04.24

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 2 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

Përmbajtja

1.	HYRJE	7
1.1.	Fjala hyrëse e Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve të KOSTT	8
1.2.	Fjala hyrëse e Kryeshefit Ekzekutiv të KOSTT sh. a	10
1.3.	Pasqyra e strukturës organizative dhe ndryshimet gjatë vitit 2023	13
2.	RAPORTI I BORDIT TË DREJTORËVE	15
2.1.	Përbërja e Bordit dhe aktivitete kryesore të ndërmarra gjatë vitit 2023	15
3.	RAPORTI I KRYESHEFIT EKZEKUTIV	18
3.1.	Arritjet kryesore	18
3.2.	Ngjarjet kryesore të vitit.....	24
4.	OPERIMI I SISTEMIT	34
4.1.	Marrëveshja e Kyçjes (Connection Agreement) KOSTT – ENTSO-E	34
4.2.	Funksionalizimi i Bllokut të Kontrollit (Control Block) AK – procedurat	34
4.3.	Krijimi dhe dërgimi i fajllave DACF (Day Ahead Control Files) në Swissgrid	34
4.4.	Kalkulimi i Net Transfere Capacities (NTC).....	34
4.5.	Publikimi i të dhënave në Platformën e Transparencën në ENTSO-E.....	35
4.6.	Pergatitja e “. uct.” fajllave dhe participimi i KOSTT në modelin vjetor ‘Y-1’ (RGCE SG Network Models & Forecast Tools NMFT).....	36
4.7.	Iniciativa e USEA/USAID e Bshkimit të Tregjeve (Market Coupling) në nivel regjional të Europës Jug – Lindore (OST, KOSTT, MEPSO)	36
4.8.	Verifikimi i Rregullt dhe Certifikimi i njëhsorëve sipas kërkesave të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2022.....	36
4.9.	Testimi i njëhsorëve për sistemet matëse në interkoneksion, gjenerim dhe distribuim.....	37
4.10.	Mbështetja me të dhëna orare nga sistemet matëse	37
4.11.	Pasqyrë e performancës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performances.....	37
4.11.1.	Bilanci i planifikuar dhe i realizuar për janar-dhjetor 2023	37
4.12.	Indikatorët Kyç të Performancës - Operimi i Sistemit.....	40
5.	OPERIMI I TRANSMISIONIT.....	41
5.1.	Rrjeti transmetues aktual i Kosovës	41

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 3 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

5.2.	Indikatorët Kyç të Performancës për operimin e transmetimit.....	44
6.	OPERIMI I TREGUT	48
6.1.	Madhësia e Tregut	48
6.2.	Hapja e tregut të energjisë elektrike në Kosovë dhe implementimi i Mekanizmit Balancues	49
6.3.	Fondi BRE (Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë elektrike).....	52
7.	PASQYRA E PERFORMANCËS DHE REZULTATET	54
7.1.	Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31.12.2023	54
7.2.	Pasqyra e të ardhurave me 31.12.2023	55
7.3.	Pasqyra e ndryshimeve në kapital	57
7.4.	Pasqyra e Rrjedhës së Parasë 31.12.2023	58
7.5.	Analiza e IKP-ve financiare.....	59
7.6.	Progresi me planin e Biznesit	60
8.	REALIZIMI I PROJEKTEVE KAPITALE GJATË VITIT 2023	67
8.1.	Projektet e menaxhuara nga Departamenti për Zhvillimin e Rrjetit dhe Projekteve janë të paraqitura në bazë të kategorive si më poshtë:	68
8.2.	Perspektiva për vitin e ardhshëm	78
8.2.1.	Në kuadër të zhvillimeve kryesore nga aspekti i operimit të tregut, do të veçohen:.....	79
8.2.2.	Menaxhimi i procesit të Ndërrimit të Furnizuesit	80
8.3.	Sfidat e KOSTT.....	81
8.4.	Aktivitetet tjera.....	81
9.	RREZIQET	82
10.	RAPORTI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM.....	84
11.	BURIMET NJERZORE	90
11.1.	Politika e personelit në KOSTT	90
11.1.1.	Struktura kualifikuese	90
11.2.	Numri i punëtorëve	91
12.	PËRMBLEDHJA DHE PËRSHKIMI I PROCEDURAVE GJYQËSORE.....	96
13.	KONTRATAT/TRANSAKSIONET E KONSIDERUESHME GJATË VITIT 2023 NGA BURIMET E KOSTT-it	127
14.	SUGJERIMET DHE PROPOZIME PËR RRRITJEN E PËRFORMANCËS	144

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 4 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

Lista e tabelave;

Tabela 1. Vendimet e Bordit për aprovimin e dokumenteve.....	16
Tabela 2. Vendimet e Bordit të ZRrE lidhur me dokumentet e dërguara për miratim	22
Tabela 3. Vlerësimi i NTC	35
Tabela 4. Bilanci i Energjisë Elektrike të planifikuara dhe të realizuara për vitin 2023	38
Tabela 5. Indikatorët Kyç të Performancës - operimi i sistemit	40
Tabela 6. Indikatorët Kyç të Performancës për operimin e transmetimit	44
Tabela 7. Prodhimi nga BRE pjesëmarrës në Skemën Mbështetëse	52
Tabela 8. Pasqyra e Pozicionit Financiar	54
Tabela 9. Pasqyra e të Ardhurave	55
Tabela 10. Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet	57
Tabela 11. Pasqyra e Rrjedhës së Parasë	58
Tabela 12. Analiza e IKP-ve financiare	59
Tabela 13. Realizimi i buxhetit të projekteve kryesore kapitale gjatë vitit 2022	69
Tabela 14. Kompanitë nënshkruese të Marrëveshjeve të Kycjes	75
Tabela 15. Aplikuesit e Energjisë së Ripërtrishme	76
Tabela 16. Departamentet dhe numri i rekomandimeve	87
Tabela 17. Evidenca e implementimit të rekomandimeve për vitin 2022	89
Tabela 18. Evidenca e implementimit të rekomandimeve për vitin 2023	89
Tabela 19. Lëvizja e punëtorëve gjatë vitit 2023	91
Tabela 20. Lendet gjyqesore	96
Tabela 21. Kontratat/Transaksionet gjatë vitit 2023 nga burimet e KOSTT-it.....	127

Lista e figurave

Figura 1. Makro Struktura Organizative Makro	14
Figura 2. https://www.seecao.com/	Error! Bookmark not defined.
Figura 3. https://transparency.entsoe.eu/dashboard/show	36
Figura 4. Bilanci i planifikuar dhe i realizuar 2023.....	39
Figura 5. Bilanci i realizuar i energjise elektrike ne GWh janar-dhjetor 2023	39
Figura 6. Shtrirja gjeografike e Sistemit Elektroenergjetik të Kosovës sipas gjendjes aktuale (2023).....	43
Figura 7. Të dhënat themelore energjetike	48
Figura 8. Tregu i rregulluar dhe pa rregulluar.....	49
Figura 9. Pjesëmarrja e blerjes së humbjeve nga KEK dhe Ankandi	51
Figura 10. Pjesëmarrja e blerjeve të energjisë nga ana e KOSTT për vitin 2022	51
Figura 11. Planifikimi dhe realizimi i auditimeve gjatë vitit 2023.....	86
Figura 12. Treguesit e auditimeve / rekomandimeve, për periudhën 2020 -2023.....	87
Figura 13. Treguesit e rekomandimeve për vitin 2023	88
Figura 14. Treguesit e rekomandimeve për vitin 2023	92
Figura 15. Punëtorët e pranuar, të pensionuar dhe me ndërprerje të MPunës.....	92
Figura 16. Numri i punëtorëve sipas departamenteve dhe gjinisë	93

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 5 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

Figura 17. Grupimi i punëtorëve sipas kualifikimit.....	93
Figura 18. Punëtorët sipas profesionit 2023	94
Figura 19. Punëtorët sipas grup moshave	94
Figura 20. Punëtorët sipas lokacionit	95

Lista e shkurtesave

AATC	(Average Available Transfer Capacity) - Kapaciteti i Disponueshëm Mesatar (Import/Eksport)
AC-DC	Shpenzimet vetanake
ACE	Area Control Error (Gabimi zones rregulluese)
AIT	(Average interruption time) - koha mesatare e rënieve
AK LFC	Blloku Kosove- Shqiperi per rregullim te frekuences
aFRR	Automatic Frekuensi restoration Reserves (Rregullimi automatik I frekuences)
ATC	(Available Transfer Capacity) – Kapaciteti i disponueshëm
BCU	(Bay Control Unit)- njësia kontrolluese
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BRE	Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë
CAO	(Capacity Allocation Office) – Zyra e Alkoimit të Kapaciteteve
CGES	(Crnogorski Elektro Sistem) – OST i Malit të Zi
CGM\OPDE	(common grid model/ operational planning data environment) - Modeli i rrjetit të bashkuar/ infrastruktura për grumbullimin e të dhënave për planifikimin operativ
CM	(Congestion Management)- Menaxhimi i kongjestioneve
QND	Qendra Nacionale Dispečerike
DACF	Day Ahead Contingency Files-Parashikimi i Kongjestionit (shtrëngesave në sistem) një ditë para
EAS	(energy awarness system) - Sistemi për vetëdijesimin me situatën energjetike
EJL	Evropa Juglindore
EMI	(Electricity Market Initiative)– Nisma për Tregun e Energjisë Elektrike
EMS	(Elektro Mreza Srbije) - Rrjeti Elektrik i Serbisë
ENS	(Energy not supplied)-Energjia e pa furnizuar
ENTSO E	(European Network of Transmission System Operators for Electricity)- Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike
FSkar	(Financial settlement of $k\Delta f$, ACE and ramping period)- Barazimi Financiar për Frekuencën Stabilizuese
HC	Hidrocentral
IKP	Indikatorët Kyç të Performancës
IPA	Instrumentet para anëtarësimit në Bashkimin Evropian
ITC	Inter TSO Compensation (Kompensimi mes Operatorëve të Sistemit të Transmetimit)
KA	Konflikt Administrativ
KAEF	(Kosovar American Education Fund) – Fondi Kosovar Amerikan për Arsim
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KESCO	(Kosovo Electricity Supply Company)- Kompania e Kosovës për Furnizim me Energji Elektrike
KfW	Banka Gjermane për Zhvillim
KOSTT	Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu
LEE	Ligji për Energjinë Elektrike

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 6 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

LFC Zonë	Load Frequency Control
LP	Largpërçuesi
MATC	Kapaciteti i Disponueshëm Maksimal (Import/Eksport)
MBE	Marrëveshja për Blerjen e Energjisë
mFRR	Rezerva Manuale për Restaurimin e Frekuencës
MEPSO	(Makedonski Elektroprenosen Sistem Operator) – Operatori i sistemit dhe transmetimit të Maqedonisë
MSA	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit
MEA	Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
NS	Nënstacioni
NP	Ndërmarrjet publike
NJPMNP	Njësia për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike
OPC	(Outage Planning Coordination) - Planifikimi i Çkyçjeve të Koordinuara
OPGW	Fibri optik
OS	Operatori i Sistemit
OST	Operator i Sistemit të Transmetimit
OT	Operatori i Transmetimit
PZhT	Plani Zhvillimor i Transmetimit
PShK	Përgjegjësia Shoqërore Korporative
RSCI	(Regional Security Coordination Initiative) – Iniciativa për koordinim të sigurisë rajonale
RGCE	Grupi Regional i Evropës Kontinentale
SAFA	Synchronous Area Framework Agreement (Marrëveshja kornizë e zonës Sinkrone)
SCADA/EMS	System Control and Data Acquisition/Energy Management System (Sistemi i kontrollit dhe grumbullimit të të dhënave/Sistemi i menaxhimit të energjisë)
SKE	Sekretariati i Komunitetit të Energjisë
SCC	(Security critical coordination) - Koordinimi i sigurisë kritike
SEE	Sistemi Elektro Energjetik
SMTA	(Short- & Medium-Term Generation Adequacy) - Adekuacia afatshkurtër dhe afatmesme e gjenerimit
SSH	Stacioni Shperndares
SHP	Shërbimët Përkrahëse
SOGL	System Operation Guidline (Udhezuesi I operimit te sistemit)
TC A	Termocentrali Kosova A
TC B	Termocentrali Kosova B
TE	(Transmitted energy)- Energjia e transmetuar
TI K	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimi
TMR	Transformatori matës i rrymës
TL	Tensioni i lartë
TTC	(Total Transfer Capacity) – kapaciteti total i bartjes
USAID	(Unated States Agenci for International Development) – Agjencioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
ZRrE	Zyra e Rregullatorit të Energjisë
ZKRP	Zyra për Komunikim dhe Relacione me Publikun
ZhRrP	Zhvillimit i Rrjetit dhe Projekteve

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 7 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

1. HYRJE

Raporti Vjetor për vitin 2023 është përpiluar bazuar në dispozitën e nenit 31.3 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike. Sipas këtij Ligji, brenda 45 ditëve pas përfundimit të vitit kalendarik, zyrtarët e NP-së do të përgatisin një raport vjetor i cili i dorëzohet Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it për miratim.

Raporti është punuar sipas formës së aprovuar nga Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike ndërsa përmbajtja e tij është e bazuar në “Udhëzuesin për përpilimin e Raportit Vjetor të Ndërmarrjes Publike”.

Raporti paraqet rezultatet kryesore të aktiviteteve të Operatorit të Sistemit, Transmetimit dhe Tregut (KOSTT) në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve gjatë vitit 2023 si dhe të aktiviteteve krahasuar me Planin e Biznesit, planin vjetor dhe shkallën e realizimit, respektivisht, implementimin e Planit të Biznesit.

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 8 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

1.1. Fjala hyrëse e Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve të KOSTT

Me rastin e përmbylljes së vitit kalendarik 2023 është koha për të reflektuar mbi punën e palodhur, sfidat dhe arritjet që janë bërë gjatë këtij viti në Operatorin e Sistemit, Transmisionit dhe Tregut- KOSTT Sh.a. Ky vit ka shënuar një periudhë të ngjeshur me angazhime dhe aktivitete të pareshtura, ku profesionalizmi dhe përkushtimi kanë qenë thelbësore, për të mundur shërbime efikase dhe të qëndrueshme në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike në tërë territorin. Andaj, është nder dhe krenari të përfaqësosh një ekip të tërë punonjësish, që në një periudhë mjaft sfiduese kanë dëshmuar që janë të pa kompromis drejt arritjes së objektivave tona.

Performanca teknike komfor normave dhe standardeve të përcaktuara janë tregues i duhur i një operimi të suksesshëm, e të cilën KOSTT ka arritur ta demonstroj edhe këtë vit.

Është kënaqësi të shohim se me miratimin e Planit Investiv Pesëvjeçar 2023-2027 si dhe me Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë me KfW-në nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, pasuar me nënshkrimin e Marrëveshjes për Nën-huazim me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, zhvillimi i rrjetit të transmisionit do të avancojë në një rrjet me infrastrukturë të krahasueshme edhe me vendet më të zhvilluara.

KOSTT-i vazhdon të ketë rol kyç në zhvillimet kryesore të sektorit të energjisë në vend. KOSTT suksesshëm po demonstroi se rruga e nisur në funksion të operacionalizimit të plotë të Bursës Shqiptare ALPEX edhe me degën në Kosovë do të përbëjë një storie suksesi dhe shembulli, jo vetëm për KOSTT-in dhe OST-në e Shqipërisë si aksionar, por edhe për rajonin.

Integriteti të cilin KOSTT-i ka ndërtuar në raport me vendet e tjera, po mundëson realizimin e një aspirate të kah motshme drejt integritetit në tregun e energjisë elektrike në Evropën Juglindore tashmë me hapa konkret siç është nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit për Bashkimin e Tregut në Evropën Juglindore ndërmjet Kosovës, Shqipërisë, Greqisë dhe Maqedonisë së Veriut.

Në përputhje me detyrimet e përcaktuara në Strategjinë Kombëtare të Energjisë, KOSTT ka zhvilluar një proces të strukturuar për shqyrtimin dhe vlerësimin e propozimeve të aplikuesve për prodhimin e energjisë nga burimet solare dhe era në territorin e Kosovës, për të siguruar kapacitetet e nevojshme në funksion të një mjedisi të pastër. Në ndërlidhje me këtë përkushtim, edhe në procesin e Para-Ofertimit për Ankandin Solar 110MW, KOSTT ka luajtur rol kyç me ekspertizën që posedon. Këto zhvillime përbëjnë një hap të rëndësishëm drejt diversifikimit të burimeve të energjisë në Kosovë dhe në krijimin e një mjedisi më të favorshëm për investime në energjinë e ripërtëritshme.

Krahas arritjeve të cilat janë evidente, nuk mund të anashkalojmë edhe sfidat me të cilat ka vazhduar të ballafaqohet KOSTT edhe gjatë këtij viti në raport me mungesën e mbulimit të humbjeve/konsumit për pjesën veriore të Kosovës. Në të njëjtën kohë është e rëndësishme të potencohet që kjo barrë është jashtë kontrollit të KOSTT-it, dhe përpjekjet për të minimizuar ndikimet negative në sistemin elektroenergjetik, kanë qenë të vazhdueshme, duke demonstruar aftësinë për të menaxhuar dhe performuar në mënyrë të duhur edhe në situata të tilla, jo të zakonshme. Megjithatë, tani nga kjo perspektivë kohore, kjo problematikë tashmë pa dyshim mund të themi që ka marrë epilogun e duhur, e cila hap rrugë që me shumë punë, angazhim dhe bashkërendim të veprimeve, të na mundësohet gëzimi i anëtarësimit në mekanizmat ndërkombëtar dhe avancimi i statusit tonë në ENTSO-E.

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 9 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

Bordi i Drejtoreve është përkushtuar plotësisht në mbështetje të menaxhmentit për të siguruar konformitetin ligjor të të gjitha akteve të brendshme dhe realizimin e objektivave strategjike. Pa angazhimin dhe përkushtimin e secilit prej jush, shumë nga këto suksese nuk do të ishin të arritshme.

Në emër të Bordit të Drejtorëve, shprehim mirënjohjen tonë të thellë dhe falënderimin për punën e palodhshme, për të siguruar shërbime cilësore në sigurinë e furnizimit të energjisë për të gjithë, të cilat janë një prerogativ dhe parakusht për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik në vend. Pa dyshim, që me një përkushtim dhe bashkërendim konsistent rezultatet dhe sukseset do të jenë treguesi me të cilat KOSTT do të identifikohet gjithnjë.

Sinqerisht i juaji,

Jeton Mehmeti

Kryesues i Bordit të Drejtorëve

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 10 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

1.2. Fjala hyrëse e Kryeshefit Ekzekutiv të KOSTT sh. a

Të nderuar/a përfaqësues të aksionarit,

Të nderuar/a palë të interesit,

Viti 2023 ishte një nga vitet më të suksesshme të Operatorit të Sistemit dhe Transmetimit në Kosovë, pas parasysh që ndër të tjera, përfundimisht hoqëm barrën shumë vjeçare të furnizimit me energji elektrike të komunave veriore të Republikës së Kosovës, e cila do të na siguroj që bilancet tona financiare të jenë përsëri pozitive. Falënderojmë pafundësisht të gjitha institucionet e përfshira në këtë proces, sepse tani sukseset nuk do të jenë më nën hije, ndërsa sfidat e paraqitura për KOSTT do të jetë lehtësisht të menaxhueshme, si një monopol i natyrshëm që jemi.

Dëshiroj të shpreh falënderimet e mia të sinqerta veçanërisht për punonjësit tanë, sepse ky sukses nuk do të ishte i mundur pa arritjet e tyre të konsiderueshme, angazhimin e tyre të jashtëzakonshëm profesional.

Për të ofruar një perspektivë profesionale mbi zhvillimet e periudhës 2023, duke theksuar rezultatet e arritura me një ndërthurje të përpiktë të aspekteve afariste, në këtë Raport Vjetor po shpalojmë një gamë edhe më të zgjeruar të arritjeve tona, në mënyrë që të vazhdojmë të jemi një shembull i mirë i menaxhimit të suksesshëm të një ndërmarrjeje publike siç është Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut të energjisë elektrike në Kosovë.

Në përkushtimin tonë për avancim në sektorin e energjisë, KOSTT ka luajtur një rol aktiv në zbatimin e kornizës rregullative për Integritet Evropian. Ne kemi theksuar angazhimin tonë në përfshirjen dhe zbatimin e masave ligjore, të përfshira në Agjendën Evropiane për Integritet dhe Planin Kombëtar të Zbatimit të Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim (PKZMSA).

Me aprovimin e Planit Investiv Pesëvjeçar të Transmetimit 2023-2027, operimi i sistemi të transmetimit do të përfitojë në shumë aspekte, duke krijuar një sistem më robust dhe të përshtatshëm për nevojat e kohës dhe për sfidat e ardhshme në fushën e energjisë.

Në vazhdimësi të bashkëpunimit të shkëlqyeshëm në mes të OST Shqipëri dhe KOSTT si aksionarë të ALPEX, së bashku me akterët relevant të sektorit punuam pa kursyer për miratim të dokumenteve në mbështetje të operacionalizimit të ALPEX, i cili do të inkurajojë investime të reja në gjenerimin e energjisë elektrike dhe në rrjetet e transmetimit në Kosovë dhe Shqipëri, si dhe shfrytëzimin më efikas të burimeve ekzistuese të energjisë në të dyja vendet.

Nënshkruam Memorandumin e Mirëkuptimit për Bashkimin e Tregut të Ditës në Avancë të Energjisë Elektrike në EJT ndërmjet Kosovës, Shqipërisë, Greqisë dhe Maqedonisë së Veriut, si palë me rol kyç në tregun e energjisë elektrike në Evropën Juglindore, iniciativë kjo e cila paraqet zgjerimin më të madh të sistemeve evropiane të energjisë elektrike me vendet jo anëtare të Bashkimit Evropian.

Gjithashtu, kemi garantuar performancë teknike të jashtëzakonshme në operimin e sistemit të transmetimit, duke përmbushur standardet e përcaktuara, teksa 99% e planeve për mirëmbajtje të linjave dhe nënstacioneve janë kryer me sukses dhe kemi arritur që të mbajmë nivelin e humbjeve edhe më të ultë se sa që kemi planifikuar.

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 11 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

Në përkushtim të përmbushjes së agjendës së gjelbër të përcaktuar në Strategjinë Kombëtare të Energjisë, kemi shqyrtuar dhe dhënë informatat teknike 20 aplikuesve me kapacitet total prej 2902,7 MW për prodhim të energjisë nga burimet solare, ndërsa 295,8 MW me erë, nëpër vende të ndryshme të Kosovës, në mënyrë që të përshpejtojmë tranzicionin energjetik.

KOSTT ka dhënë ekspertizën duke ofruar analizën e kyçjes në procesin e Para-Ofertimit për Ankandin Solar 100 MW, ankandi ky i parë i burimeve të ripërtërishme i cili shënoi një fazë të re për sektorin e energjisë në Kosovë dhe do të krijojë një ambient më të favorshëm për BRE-të.

Përfundimisht në vitin 2023, vumë nismat e para për ndërtimin e Nënstacionit të ri në Malishevë dhe Dragash, projekte këto përveç rëndësisë që e kanë në përforsimin dhe zhvillimin e rrjetit të transmetimit, njëkohësisht krijojnë kushte për integrim dhe operim të sigurt të burimeve të ripërtërishme të energjisë në atë rajon, e që janë objektiva afatgjate të politikave energjetike të vendit.


Pas një pritje të gjatë, Kuvendi i Republikës së Kosovës votoi projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë dhe projektit ndërmjet Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, KOSTT (Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu sh. a.) dhe KFW, Frankfurt AmMain (KFW), e cila hapi rrugën për nënshkrimin e Marrëveshjes për Nën-huazim për Projektin "Zhvillimi i sektorit të energjisë Faza VII – Përmirësimi i Rrjetit të Transmetimit", përmes së cilës do të bëhet financimi i një sërë projekteve të radhës për zhvillimin dhe modernizimin e infrastrukturës së transmetimit të energjisë elektrike në Kosovë.

Përmes bashkëpunimit të ngushtë ndër vite në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Fondit të Sfidave të Mijëvjeçarit (MCC) e cila në kuadër të programit Kompakt, synon instalimin e sistemit të ruajtjes së energjisë nëpërmjet baterive me kapacitet prej 170 MW (apo 340 MWh), me një vlerë totale prej 180 milion \$, KOSTT do të përftojë kapacitetin 45 MW në vlerë prej 42.6 milion \$, kemi konkretizuar të gjithë hapat drejtë nënshkrimit të Marrëveshjes për Zbatimin e aktivitetit për instalimin e sistemit të ruajtjes të energjisë përmes baterive në kuadër të Marrëveshjes "Kompakt" ndërmjet MCC-së dhe Republikës së Kosovës.

Në funksion të zgjerimit të ofrimit të shërbimeve, me mbështetjen e Bankës Botërore, aplikuar në WBIF për grant për projektin "Balkans Digital Highway" që përfshin katër vende nga Ballkani Perëndimor. Faza e Parë përfshiu studime fizibiliteti të ndryshme të cilat përfunduan në dhjetor 2023 dhe me këtë siguroam pjesëmarrjen në Fazën e Dytë të projektit.

Pas një periudhe të gjatë dhe në përputhje me Udhërrëfyesin e Energjisë, KEDS nënshkroi marrëveshje komerciale me Elektrosever e cila i hapi rrugë regjistrimit të Elektroseverit sipas procedurave dhe rregullave të tregut, meqe rast fillimit të nominimit për furnizim me energji të pjesës veriore të Kosovës, me këtë rast barra e KOSTT për furnizim të pjesës Veriore të Kosovës u largu.

Dhe me kaq nuk do të mjaftohemi, përkundër sukseseve dhe të arriturave të shumta, kemi punuar dhe vazhdojmë të punojmë në projektet e së nesërme, me përkushtim maksimal në rritjen e qëndrueshmërisë energjetike dhe të investojmë në inovacion dhe teknologji, për të sjellë përmirësim të dukshëm të efikasitetit të operimit.

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 12 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

Së bashku, kemi arritur të ndërtojmë histori sukseesi, dhe jam i bindur se me përkushtimin tonë të vazhdueshëm dhe angazhimet në ngritjen e sigurisë së furnizimit dhe avancimit të mëtutjeshëm të sistemit të transmetimit, do të shohim një Kosovë të ndriçuar në shkallë më të mirë.

Në cilësinë e Kryeshefit Ekzekutiv, dhe në emër të të gjithë punonjësve në KOSTT ju falënderojmë për mbështetjen tuaj të vazhdueshme në rrugën tonë drejt suksesit.

Evetar Zeqiri

Kryeshef Ekzekutiv

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 13 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

1.3. Pasqyra e strukturës organizative dhe ndryshimet gjatë vitit 2023

Më 25 prill 2018, Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it në mbledhjen nr.103/18, ka aprovuar Riorganizimin e brendshëm të KOSTT, përkatësisht makro skemën organizative.

Ndryshimet janë reflektuar në shumicën e departamenteve, zyrave dhe sektorëve brenda në departamente. Ndryshimet në harmoni me vendimet e Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefit Ekzekutiv janë implementuar nga 01.05.2018 dhe shihen në Makro Skemën Organizative të KOSTT.

Sipas kësaj strukture, menaxhmenti më i lartë i KOSTT-it përbëhet nga pozitat vijuese: Kryeshefi Ekzekutiv (KE), Zëvendës Kryeshefi Ekzekutiv; Sekretari i Kompanisë; Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit, Zyrtari i Auditimit të Brendshëm dhe drejtorët e departamenteve vijuese:

- Operatori i Sistemit;
- Operatori i Transmetimit;
- Operatori i Tregut;
- Zhvillimi i Rrjetit dhe Projekteve;
- Çështjet Rregullative dhe Tarifa;
- Financat dhe Thesari;
- Burimet Njerëzore;
- Shërbimet Përkrahëse;
- Prokurimi; dhe
- Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv, që mbulon Zyrën për Zhvillimin dhe Planifikimin Afatgjatë, Zyrën për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun, Zyrën Ligjore dhe Menaxheri për Cilësi dhe Politika.

Ekzistojnë një sërë çështjesh që do të kenë ndikim në organizimin e KOSTT-it, si:

- Zhvillimi i sistemit të Transmetimit nga këndvështrimi i kapaciteteve të rrjetit dhe kontrollimit të tij;
- Nevoja për të arritur nivel më të lartë efikasiteti brenda kompanisë;
- Nevoja për zhvillim të stafit dhe për zhvillim të infrastrukturës si rrjedhojë e integritimeve në institucionet ndërkombëtare Evropiane dhe rajonale, si dhe ndryshimeve dhe zhvillimeve në tregun e energjisë elektrike;
- Hyrja e KOSTT-it në tregun e telekomunikimeve të Kosovës dhe në tregun e telekomunikimeve dhe integrimin me vendet e rajonit, duke filluar iniciativën me OST-të fqinje (nga Banka Botërore ka filluar interesimi për të mbështet fillimin e një projekti për ndarjen e infrastrukturës ndërkufitare të telekomunikacionit respektivisht të fibrave optik), me ofrim të rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike.

Struktura organizative e KOSTT-it




Figura 1. Makro Struktura Organizative

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 15 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

2. RAPORTI I BORDIT TË DREJTORËVE

2.1. Përbërja e Bordit dhe aktivitete kryesore të ndërmarra gjatë vitit 2023

Bordi i Drejtorëve të KOSTT i zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në pajtim me Ligjin për Ndërmarrjet Publik dhe Ligjin për Energjinë Elektrike gjatë vitit 2023 ka qenë në këtë përbërje:

- Jeton Mehmeti (Kryesues)
- Arben Dodaj, Anëtar
- Nebih Zariqi, Anëtar
- Ajrina Gashi Hamdiu, Anëtare
- Liza Marku, Anëtare
- Sead Mujovi, Anëtar, dhe
- Evetar Zeqiri, Anëtar/Kryeshef Ekzekutiv

Bazuar në Ligjin për Ndërmarrje Publike Kryeshefi Ekzekutiv është anëtar i Bordit të Drejtorëve sipas detyrës zyrtare. Pëveç Kryeshefit Ekzekutiv, të gjithë antëtarët tjerë, janë anëtarë jo e ekzekutiv të Bordit të Drejtorëve. Gjatë vitit 2023 Bordi i Drejtorëve të KOSTT ka mbajtur 9 mbledhje të rregullta. Bordi i Drejtorëve ka shqyrtuar dhe miratuar të gjitha çështjet e parapara me planin e punës së Bordit të Drejtorëve, të cilat hyn në kuadër të obligimeve ligjore, si dhe në kuadër të përgjegjësive që ka, ka miratuar politika, raporte dhe procedura përkatëse.

Gjatë vitit 2023, po ashtu edhe Komisioni i Auditimit i zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në pajtim me Ligjin për Ndërmarrjet Publik dhe Ligjin për Energjinë Elektrike ka qenë në përbërje të plotë si në vijim: Liza Marku, Kryesuese dhe Arben Dodaj e Sead Mujovi anëtar.

Komisioni i Auditimit gjatë vitit 2023 ka mbajtur gjithsej 9 mbledhje të rregullta, ku krahas shqyrtimit dhe miratimit të raporteve dhe dokumenteve përkatëse, ka adresuar rekomandime për miratim të materialeve respektive tek Bordi i Drejtorëve në kuadër të fushë veprimtarisë që ka.

Përveç çështjeve dhe aktiviteteve të lartë shënuara, Bordi i Drejtorëve në ushtrimin e të drejtave dhe detyrave sipas Ligjit për Ndërmarrjeve Publike, në vazhdimësi ka shqyrtuar performancën e KOSTT dhe ka qenë mbështetës për menaxhmentin në arritjen e objektivave të përcaktuara në Planin e Biznesit.

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 16 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

Kompensimi i Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it dhe Komisionit të Auditimit është bërë bazuar në Vendimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës me nr.05-V-389 të datës 01.12.2016.


Në vazhdim janë paraqitur Vendimet e Bordit për aprovimin e dokumenteve si në vijim:

Tabela 1. Vendimet e Bordit për aprovimin e dokumenteve

Nr.	Vendimet e Bordit për aprovimin e dokumenteve si vijon:
1	Miratimi i ndarjes buxhetore për mbulimin e shpenzimeve sipas aneks Marrëveshjes së monitorimit dhe kontrollit e lidhur në mes të Ministrisë së Ekonomisë dhe KOSTT
2	Raporti për tremujorin e katërt 2022 (TM4 2022)
3	Elaborati i regjistrimit vjetor të pasurisë së KOSTT për vitin 2022
4	Miratimi i Ndryshim Plotësimit të Politikës për shfrytëzim të telefonisë mobile
5	Miratimi i Politikës për Provizionim të llogarive të arkëtueshme
6	Miratimi i Ndryshim Plotësimit të Politikës për Rekrutim
7	Miratimi i Ndryshim Plotësimit të Manualit të Punëtorëve
8	Plani i punës për Bordin e Drejtorëve dhe Komisionin e Auditimit për vitin 2023
9	Raporti Vjetor për vitin 2022
10	Raporti për kënaqësinë e konsumatorit për vitin 2022
11	Miratimi i kërkesës për shtim të linjës buxhetore në buxhetin e vitit 2023 për projektin “Përmirësimi i izolimit të anës 220kV në NS Kosova A”
12	Miratimi i kërkesës për ndryshimin gjegjësisht rritjen e buxhetit për projektin “Furnizimi dhe instalimi i transformatorit 40MVA në NS 110/35/10 (20) kV Fushë Kosova”
13	Miratimi i kërkesës për aprovimin e buxhetit për projektin “Vazhdimi i licencave të antivirusit F-Secure”
14	Raporti i Auditorit të Jashtëm për auditim të pasqyrave financiare për vitin 2022
15	Miratimi i Politikës për Siguri dhe Shëndet në Punë
16	Miratimi i Ndryshim Plotësimit të Politikës për shfrytëzimin e automjeteve zyrtare
17	Miratimi i kërkesës së Shoqatës së Pavarur Sindikale KOSTT për ndarjen e mjeteve në mbështetje financiare për punëtorë të KOSTT
18	Raporti për tremujorin e parë 2023 (TM1 2023)

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 17 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

19	Miratimi i Ndryshim Plotësimit të Politikës së dosjeve personale të punëtorëve
20	Plani i Biznesit i Rishikuar për vitin 2023
21	Buxheti i Rishikuar për vitin 2023
22	Miratimi i Ndryshim Plotësimit të Politikës për nivelin e autorizimeve
23	Miratimi i Ndryshim Plotësimit të Politikës për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës
24	Raporti për tremujorin e dytë 2023 (TM2 2023)
25	Themelimi i Komisioneve tjera të Bordit të Drejtorëve
26	Vlerësimi i Efektshmërisë së Bordit të Drejtorëve për vitin 2022
27	Miratimi i Ndryshim Plotësimeve në Politikën e Praktikës Profesionale
28	Miratimi i Procedurës për zgjedhjen e anëtarëve në Këshille/Borde Mbikëqyrëse në Shoqëri Aksionare apo Organizata tjera në bashkëpronësi të KOSTT
29	Miratimi i kërkesës për dorëheqje të Zëvendës Kryeshefit Ekzekutiv të KOSTT
30	Buxheti për vitin 2024
31	Plani i Biznesit për vitin 2024
32	Plani i Biznesit 2023-2027
33	Plani Zhvillimor i Transmetimit 2024-2033
34	Miratimi i Ndryshim Plotësimit të Politikës së rekrutimit
35	Miratimi i Ndryshim Plotësimit të Politikës për orarin e punës
36	Miratimi i Ndryshim Plotësimit të Politikës për kompensim të punëtorëve
37	Miratimi i Ndryshim Plotësimit të Politikës për nivelin e autorizimeve
38	Miratimi i Ndryshim Plotësimit të Manualit të Punëtorëve
39	Raporti për tremujorin e tretë 2023 (TM3 2023)
40	Miratimi i Përshkrimit të vendit të Punës dhe kriterëve për pozitën e Zëvendës Kryeshefit Ekzekutiv dhe Shpallja e Konkursit
41	Miratimi i Ndryshim Plotësimit të Rregullores së definimit të kriterëve teknike për zhvendosjen e linjave ajrore dhe kablllore të tensionit të lartë 110kV
42	Miratimi i Ndryshim Plotësimit të Procedurës për prokurimin e shërbimeve ndihmëse

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 18 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

43	Miratimi i Draft Marrëveshjes për nën huazim me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu KOSTT Sh.a për kredinë me KfW
44	Miratimi i ndarjes buxhetore për mbulimin e kostove të devijimeve të energjisë elektrike në katër komunat veriore

3. RAPORTI I KRYESHEFIT EKZEKUTIV

3.1. Arritjet kryesore

Përpjekjet e KOSTT-it qysh nga themelimi, ishin dhe do të jenë edhe në të ardhmen, të orientuara drejt realizimit të objektivave të saj strategjike, të cilat janë në përputhje të plotë me rolin, misionin dhe vizionin e KOSTT-it. Duke u bazuar në të gjitha këto, edhe gjatë vitit 2023 përkundër vështirësive të mëdha që kanë ndodhur si rezultat i vazhimit të krizës energjetike në vend dhe regjion, KOSTT ka vazhduar trendin e saj të performimit pozitiv, duke dëshmuar kështu se mbetet edhe më tutje një organizatë e qëndrueshme dhe efektive.

KOSTT ka zhvilluar infrastrukturën e operimit të sistemit dhe tregut, dhe tani është duke u përgatitur për sfidat e reja me të cilat do të përballlet në të ardhmen.

Gjatë vitit 2023 ka vazhduar me sukses operimi i KOSTT si zonë e pavarur rregulluese në kuadër të zonës sinkrone të Evropës Kontinentale si pjesë e bllokut Kosovë- Shqipëri respektivisht blloku AK.

Gjatë vitit 2023 ka vazhduar të ketë kërkesa për krijimin e kushteve për implementimin e projekteve të reja dhe rehabilituese të rrjetit të transmetimit, si dhe për mirëmbajtje të planifikuar. Janë bërë të gjitha përgatitjet gjatë fazës planifikuese dhe në kohë reale për operim të sistemit sa më të besueshëm, duke bërë koordinimin e gjithmbarshëm të shkyçjeve në aspektin brenda Kosovës si dhe në nivel rajonal. Përkundër këtyre rrethanave gjatë vitit 2023 është arritur që të mirëmbahet siguria e furnizimit dhe që kohëzgjatja e mos furnizimit të jetë e kontrollueshme.

Në mesin e detyrave të KOSTT dhe në përputhje me objektivat e saj strategjike, një nga detyrat kryesore mbetet edhe më tutje ofrimi i shërbimeve kualitative dhe të besueshme për përdoruesit e sistemit të transmisionit. Sa i përket përmbushjes së kësaj detyre, KOSTT ka vazhduar trendin e performimit pozitiv, edhe gjatë vitit 2023.

Njëkohësisht, që të sigurohet operim i sistemit sa më efikas, është vazhduar me investimet në rehabilitimin e nënstacioneve sipas prioriteteve të caktuara në bazë të gjendjes funksionale të tyre.

Implementimi i suksesshëm i mirëmbajtjes dhe projekteve ndihmon në përmbushjen e objektivave themelore të KOSTT-it, në radhë të parë, në rritjen e kapacitetit të transmetimit, modernizimin e sistemit dhe mirëmbajtjen preventive, gjë që do të ndikojë në rritjen e besueshmërisë dhe sigurisë së sistemit, që është në përputhje me vizionin dhe misionin e KOSTT.

Gjatë këtij viti është realizuar 99% e planit vjetor të mirëmbajtjes së linjave, 95% e mirëmbajtjes së Qarqeve Primare, 98% i Qarqeve Sekondare dhe 89% i Mbrojtjeve Rele, si dhe janë zhvilluar aktivitetet e tjera të

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 19 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

domosdoshme për sigurinë dhe stabilitetin e qëndrueshëm operativ dhe të sigurisë së sistemit elektroenergjetik.

Me qëllim të mirëmbajtjes sa më efektive, shfrytëzohet Rregullorja e Mirëmbajtjes e cila për bazë ka metodologjitë më të avancuara të qasjes në stabilimente duke marrë parasysh teknologjinë e përdorur si dhe afatet e duhura kohore për mirëmbajtje dhe shqyrtime të pajisjeve elektrike. Përmes kësaj synohet që oraret dhe aktivitetet e mirëmbajtjes në pajisje, të jenë sa më racionale duke u bazuar në gjendjen e pajisjeve. Në këtë mënyrë do të kursehet koha dhe kostoja e mirëmbajtjes.

Gjatë tërë vitit 2023 ka vazhduar puna e grupeve punuese KOSTT-OST për të mundësuar implementimin e Marrëveshjes së Bllokut Rregullues të Sistemeve Energjetike Kosovë-Shqipëri (Blloku AK). Kjo marrëveshje obligon palët (KOSTT dhe OST) të punojnë bashkërisht në operimin e bllokut të përbashkët sipas detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshja SAFA dhe SOGL si dhe në harmoni me kodet nacionale të rregullimit.

Përkushtimi i KOSTT-it, për arritjen e objektivit të kompanisë siç është përgjegjësia në aspektin e sigurisë dhe mjedisit, ka vazhduar edhe gjatë vitit 2023. Viti është përmbyllur pa asnjë incident, lëndim të punëtorëve apo emergjencë mjedisore.

Opinionin e auditorit të jashtëm për pasqyrat financiare për vitin 2022 është pa asnjë kualifikim, duke filluar qysh nga viti 2006. Kjo e arritur dëshmon më së miri punën profesionale dhe përkushtimin e KOSTT në zbatimin e standardeve më të larta në proceset e punës dhe përmbylljen me shumë sukses të shfrytëzimit të gjitha resurseve. Veç kësaj, KOSTT ka kryer me kohë obligimet ndaj klientëve dhe Institucioneve të shtetit të Kosovës përveç detyrimeve të cilat rrjedhin nga llogaria e balancimit.

Në kuadër të procesit të implementimit të kornizës rregullative të sektorit të energjisë që ndërlidhet me procesin e Integritimeve Evropiane, KOSTT vazhdimisht ka qenë dhe është pjesë e procesit të raportimit mbi implementimin e masave ligjore dhe zbatuese të përfshira brenda Agjendës Evropiane për Integrim dhe Planit Kombëtar të Zbatimit të Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim (PKZMSA) duke mos anashkaluar edhe Planin e Vjetor të Punës së Qeverisë së Kosovës (PVPO) si pjesë ndërlidhëse me këtë proces integruar.

Sipas kërkesave nga legjislacioni primar dhe nga legjislacioni sekondar, sipas afateve të përcaktuara nga ZRRE, KOSTT ka përgatitur dhe ka dërguar në ZRRE dokumente dhe aplikacione për miratim:

- KOSTT ka përgatitur dhe dërguar në ZRRE komentet ndaj Raportit Konsultativ për të Hyrat e Lejuara Maksimale për Periudhën e tretë Rregullative;
- Aplikimi për Tarifa të OST/OT për vitin 2023, dërgimi në ZRRE i shkresës dhe Modelit Tarifor 2023;
- Pjesëmarrja në përgatitjen e Planit Investiv Pesëvjeçar të Transmetimit 2023-2027 si dhe dërgimi në ZRRE;
- Përgatitja e komenteve dhe arsyeshmërive për Planin Investiv sipas kërkesave të ZRRE-së dhe dërgimi i tyre në ZRRE së bashku me Listën e Projekteve Kapitale 2023-2027 dhe Planin Zhvillimor të Transmetimit 2023-2032 të përditësuar;
- Përgatitja e Njoftimeve për Tarifa 2023 dhe publikimi i tyre në webfaqen e KOSTT-it;

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 20 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

- Sipas kërkesës së ZRRE është përgatitur dhe dërguar Plani i Punës për gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2023;
- Komentimi në Draftin e parë i Projektligjit për Energjinë Elektrike;
- Përfundimi i raportit mbi zhvillimin e aktiviteteve me anë të Modelit Financiar për gjashtëmuajorin e parë 2023;
- Përgatitja e Aplikacionit për Anëtarësim në ALPEX – Përgatitja e Aplikacionit të KOSTT dhe të gjitha dokumenteve tjera përcjellëse dhe dërgimi i tyre në ALPEX;
- Plotësimet dhe ndryshimet në Planinin e Biznesit dhe Buxhetin për periudhën 2023-2023, Planin e Biznesit për vitin 2023 si dhe Buxhetin për vitin 2023;
- Modeli për Planifikim Financiar Afatgjatë - takim me përfaqësuesit e KPMG në Shkup lidhur me njoftimin e kushteve tona për mirëmbajtje të Modelit Financiar dhe harmonizimit të takimit të radhës;
- Azhurnimet vjetore për të hyrat e lejuara për vitin 2024 - Pranimi nga ZRRE njoftimin për fillimin e procesit të azhurnimit për të hyrat e lejuara për vitin 2024, po ashtu dhe Modelin në excel i cili duhet të plotësohet nga KOSTT për azhurnimin e të hyrave. Ndarja e detyrave dhe përgjegjësi për secilin departament për plotësim;
- Përfundimi i raportit mbi zhvillimin e aktiviteteve me anë të Modelit Financiar për gjashtëmuajorin e dytë 2023;
- Analiza e Tarifave për vitin 2022- Përgatitja e dokumentit në excel mbi Analizën e Tarifave për vitin 2022 si dhe Raportit për të;
- Analiza e Tarifave 2007-2022 - Përgatitja e dokumentit në excel mbi Analizën e Tarifave për periudhën 2007-2022 si dhe raportit për të;
- Baza e të dhënave për Tarifa 2007-2022 - përgatitja e raportit për bazën e të dhënave për periudhën 2007-2022;
- Analiza e Tarifave për gjashtëmuajorin e parë 2023- Përfundimi i dokumentit në excel për analizën e tarifave për gjashtëmuajorin e parë 2023 dhe raportit në word;
- Kërkesat për Derogime të veçanta dhe Raportet e Derogimeve për Kodin e Rrjetit të Transmetimit dhe Licencën e OST-s, lidhur me dispozitat të cilat nuk janë në implementim;
- Plani preliminar Pesëvjeçar Investues i Transmetimit 2023 – 2027;
- Plani i Adekuacisë së Gjenerimit 2023 - 2032;
- Plani Zhvillimor i Transmetimit 2023 – 2032, i plotësuar sipas dakordësimit me ZRRE;
- Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike 2023, ver. 0.3 pas përditësimit të të dhënave nga KEDS/ KESCO;
- Bilanci Afatgjatë i Energjisë Elektrike 2023 – 2032, i harmonizuar sipas BVEE 2023;
- Kërkesë për Ndryshimin e Vendimit të ZRRE V_1680_2023, bazuar në sqarimet shtesë;
- Kërkesë për Ndryshimin e Vendimit të ZRRE V_1681_2023, bazuar në sqarimet shtesë;
- Kërkesë për miratimin e Rregullave të Tregut, ver 3.1;
- Kërkesë për amendim të Procedurës së Garancionit Financiar;
- Kërkesë për miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës;
- Kërkesë për miratimin e Procedurës së Rregullave të Tregut për Nominimet;

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 21 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

- Kërkesë për miratim të Metodologjisë së shpërndarjes së të ardhurave dhe Procedurës rezervë për bashkimin e tregut të Energjisë elektrike të ditës në avancë Shqipëri – Kosovë;
- Aplikacioni fillestar i KOSTT për anëtarësim në ALPEX;
- Kërkesë për miratimin e Rregullave për Alokim në Hije (Shadow) për kufirin Shqipëri – Kosovë;
- Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike 2024, i dërguar në Ministrinë e Ekonomisë për dhënje të Mendimit si dhe dërguar në ZRrE për miratim;
- Kërkesa për miratim të Sasisë së Kapaciteteve transmetuese ndërkufitare Shqipëri – Kosovë për procesin e bashkimit të tregjeve;
- Plani Zhvillimor i Transmetimit 2024 – 2033;
- Plani 5 Vjeçar Zhvillimor i Transmetimit 2024 – 2028; dhe
- Inicimi i Kontestit ndaj KEK.Sh.A.

KOSTT ka përgjegjësi që në ZRrE të dërgoj Raporte të ndryshme sipas obligimeve nga Licenca e OST-s dhe OT-s, si dhe sipas rasteve vetëm për njoftim apo edhe sipas kërkesës nga ZRrE:

- Regjistri i Aseteve 2022;
- Raport mbi realizimin e Projekteve Kapitale për vitin 2022;
- Raport mbi Mangësitë e Sistemeve Matëse dhe Rekomandim për Sistemet Matëse;
- Kontrata me Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare për mFRR;
- Regjistri i Aplikuesve për Kycje në Rrjetin e Transmetimit deri në fund të vitit 2022;
- Raportet tremujore dhe vjetore të pajtueshmërisë me kushtet e Licencave për Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Raportet mbi veprimtarinë e Operatorit të Sistemit, Operatorit të Transmetimit dhe Operatorit të Tregut;
- Pasqyrat Financiare Vjetore të audituara dhe Raportin e Auditorit të pavarur dërguar në ZRrE dhe ARKEP;
- Raportet mujore për blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit dhe raportin mujor për blerjen e energjisë elektrike balancuese në ankandet ditore të organizuara nga KOSTT;
- Raportet tremujore lidhur me energjinë e nominuar të BRE-ve, dërguar në Agjencionin e Statistikave të Kosovës;
- Të dhënat për energjinë e importuar nga KOSTT gjatë vitit 2022, sipas kërkesës nga ZRrE;
- Të dhëna për vitin paraprak të cilat kërkohen për Raportin Vjetor të ZRrE;
- Të dhëna për aktivizim të mFRR në MWh dhe Euro, si dhe rastet e refuzimit nga ana e KESH për ofrimin e shërbimit të mFRR për arsye teknike të avarive të ndryshme të njëjësive në kohë reale, sipas kërkesës nga ZRrE;
- Pasqyrat Financiare Vjetore 2022 të audituara të dërguara në ZRrE dhe ARKEP;
- Plotësimi i Raportit të kontributit_Inputit të parë për Raportin e KE-s për Kosovën sipas kërkesës nga Zyra e Kryeministrit;
- Lista e dokumenteve që do të dërgohen gjatë vitit 2024 _ Plani i Punës së ZRrE, sipas kërkesës nga ZRrE;

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 22 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

- Shtojca e MBE-së – Përdorimi i Kontratës për Diferencë (CfD) e dërguar tek KEK dhe KESCO;
- Njoftim për shkelje të rregullave të tregut nga pala KEDS;
- Njoftim për shkelje të rregullave të tregut nga pala tregtare KESCO;
- Njoftim për shkelje të rregullave të tregut nga pala tregtare KEK;
- Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike për vitin paraprak 2022 i dërguar në Agjesionin e Statistikave të Kosovës;
- Raport mbi implementimin e Kodit të Rrjetit të Transmetimit për vitin 2022;
- Kërkesë për interpretim ligjor dhe rregullativ në raport me marrëveshjet e kyçjes në rrjetin e transmetimit;
- Marrëveshjet për Aderim në Rregullat e Tregut dhe Marrëveshjet për Palët Përgjegjëse për Balanc me Palën Tregtare MFT Energy Kosovo L.L.C, Palën Tregtare Eurosol & Energy LTD Sh.P.K., Palën Tregtare MONTING Sh.P.K.

Tabela 2. Vendimet e Bordit të ZRrE lidhur me dokumentet e dërguara për miratim

Nr.	Dokumenti	Qëllimi	Vendimi i Bordit të ZRrE
1	Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike 2023	Në pajtim me Ligjin për EE, Licencën e OST, Rregullën edhe Metodologjinë për përgatitjen e Bilanceve të Energjisë	V_1678_2023
2	Derogimet për Kodin e Rrjetit të Transmetimit	Në pajtim me Kodin e Rrjetit të Transmetimit	V_1679_2023
3	Ankesa e KOSTT ndaj KEDS_si e bazuar	Në pajtim me Ligjin për Energji Elektrike dhe Rregullat e Tregut	V_1680_2023
4	Ankesa e KOSTT ndaj KESCO_si e bazuar	Në pajtim me Ligjin për Energji Elektrike dhe Rregullat e Tregut	V_1681_2023
5	Të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR)	Sipas Ligjit për Energjinë Elektrike dhe Rregullës për të Hyrat e OST/OT)	V_1705_2023
6	Plani Pesëvjeçar Zhvillimor i Transmetimit 2023 - 2027	Në pajtim me Rregullën Nr. 03/2017 për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (OST/OT)	V_1708_2023
7	Plani Zhvillimor i Transmetimit 2023 - 2027	Në pajtim me Ligjin për Energji Elektrike	V_1710_2023
8	Tarifat për shfrytëzimin e sistemit të transmetimit, operimit të sistemit dhe tregut (KOSTT Sh. A.)	Sipas Ligjit për Energjinë Elektrike dhe Rregullës për të Hyrat e OST/OT)	V_1712_2023
9	Ndryshim dhe plotësim i V_1680_2023	Në pajtim me Rregullat e Tregut	V_1716_2023
10	Ndryshim dhe plotësim i V_1681_2023	Në pajtim me Rregullat e Tregut	V_1717_2023

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 23 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

11	Denim me gjobë	Bazuar në Ligji për RrE, Ligji për EE, Rregullat e Tregut	V_1739_2023
12	Bilanci Afatgjatë i Energjisë Elektrike 2023 - 2032	Në pajtim me Ligjin për Energjinë, Licencën e OST	V-1744_2023
13	Plani i Adekuacisë së Gjenerimit 2023 - 2032	Në pajtim me Kodin e Rrjetit të Transmetimit – Kodi i Planifikimit	V_1745_2023
14	ALPEX Sh. A. përcaktohet si NEMO	Në pajtim me Ligjin për EE, Rregullën 04/2020, Licencën e OST	V_1748_2023
15	Ankesa e KOSTT si e bazuar	Në pajtim me Ligjin për EE, Ligjin për RrE, Rregullën për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve, Rregullat e Tregut	V_1761_2023
16	Tarifat për periudhën tranzitore të Bursës Shqiptare (ALPEX)	Në pajtim me Ligjin për EE, Rregullat e ALPEX, Rregullën 04/2020,	V_1766_2023
17	Metodologjia e Shpërndarjes së të Ardhurave nga Kongjestionin ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës	Në pajtim me Marrëveshjen Kornizë mbi bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike	V_1767_2023
18	Propozimi për aprovimin e produkteve dhe llojet e urdhërporosive që do të tregtohen në Bursën Shqiptare ALPEX Sh. A.	Në pajtim me Rregullat e ALPEX, Procedurën e Tregtimit të ALPEX	V_1768_2023
19	Rregullat për Alokimin në Hije për kufirin mes Shqipërisë dhe Kosovës.	Në pajtim me SEE CAO	V_1769_2023
20	Procedura Rezervë për Bashkimin e Tregut të Energjisë Elektrike të Ditës në Avancë për Rep. e Shqipërisë dhe Rep. e Kosovës	Në pajtim me Marrëveshjen Kornizë mbi bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike	V_1770_2023
21	Modeli i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës	Në pajtim me Ligjin për EE	V_1781_2023
22	Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike	Në pajtim me Ligjin për EE, Licencën e OT, Licencën e OST	V_1782_2023
23	Miratimi i Sasisë së Kapaciteteve Transmetuese Ndërkufitare Shqipëri – Kosovë për procesin e bashkimit të tregut	Në pajtim me Ligjin për EE, Marrëveshjen Kornizë mbi bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike, Modelin e Tregut të Energjisë Elektrike	V_1792_2023
24	Vërtetohet se është plotësuar pika II e dispozitivit të Vendimit V_1748_2023 dhe Refuzohet propozimi i Strukturës Organizative të ALPEX	Dispozitivi pika II e Vendimit V_1748_2023	V_1793_2023

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 24 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

3.2. Ngjarjet kryesore të vitit

Janar 2023

Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT-it priti në takim delegacionin e Korporatës së Sfidave të Mijëvjeçarit- MCC

Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT, z. Evetar Zeqiri, priti në takim përshëndetës znj. Sarah Olmstead nga MCC ku diskutuan angazhimet për mbështetjen e projektit të sistemit akumulues të baterive 90MWh. Gjatë takimit, u njoftua edhe me z. Rinor Gjonbalaj, Drejtor për Kosovë-MCC, dhe znj. Caitlin L. Reichart, zv. Drejtoreshë për Kosovë. Diskutimet përqendruan në përgatitjet për detyrat nga marrëveshja e Programit Kompakt midis Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të përfaqësuar nga MCC.

Shkurt 2023

Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT priti në takim delegacionin e International Finance Corporation-IFC

Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT, z. Evetar Zeqiri, gjatë muajit shkurt priti në takim delegacionin e IFC Kosovë të përbërë nga z. Visar Perani, z. Boris Janjalija, dhe znj. Arbnora Jashanica nga IFC. Diskutimi kryesor i takimit ishte avansimi i qeverisjes korporative në ndërmarrjen e KOSTT-it, për të siguruar efikasitet në udhëheqje dhe rrit vlerën për aksionarët. Me këtë rast Kryeshefi Ekzekutiv paraqiti procedurat e qeverisjes korporative në KOSTT, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Kryesuesi i Bordit të KOSTT dhe Kryeshefi Ekzekutiv pritën në takim përfaqësuesit e Ambasadës së SHBA-s në Kosovë

Në korniza të bashkëpunimit dhe partneritetit të vazhdueshëm me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve të KOSTT z. Jeton Mehmeti dhe menaxhmenti i lartë i KOSTT-it në krye me Kryeshefin Ekzekutiv z. Evetar Zeqiri, pritën në takim përfaqësuesit e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Kosovë, z. D.R. Seckinger, Udhëheqës i njësisë ekonomike dhe znj. Kelly Dodge, Zyrtare Ekonomike. Gjatë takimit diskutuan rreth funksionimit të përgjithshëm të Sistemit të Transmetimit të Kosovës si dhe angazhimet e KOSTT-it në operimin e Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike në funksion të sigurisë së furnizimit me energji elektrike për të gjithë qytetarët e vendit.

U mbajt mbledhja e radhës e Asamblesë së Përgjithshme të ALPEX

Në mbledhjen e radhës së Asamblesë së Përgjithshme të ALPEX, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT, z. Evetar Zeqiri dhe Administratori i Përgjithshëm i OST Shqipëri, z. Skerdi Drenova, në cilësinë e aksionarëve të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX) miratuan Programin e Zhvillimit Ekonomik të ALPEX për vitin 2023 dhe caktimin e Audituesëve Ligjor të ALPEX për auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2022. Me këtë rast, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Zeqiri theksoi “Miratimi i këtyre dokumenteve do të inkurajojë investime të reja

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 25 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

në gjenerimin e energjisë elektrike dhe në rrjetet e transmetimit në Kosovë dhe Shqipëri, si dhe shfrytëzimin më efikas të burimeve ekzistuese të energjisë në të dyja vendet“.

Mars 2023

Në prag të Ditës Ndërkombëtare të Gruas, znj. Atifete Jahjaga vizitoi KOSTT-in

Më 3 mars 2023, ish Presidentja e Republikës së Kosovës dhe themeluese e Fondacionit Jahjaga, znj. Atifete Jahjaga vizitoi KOSTT, ku u prit në takim nga Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Evetar Zeqiri si dhe mbajti një ligjëratë për gratë punonjëse të KOSTT. Me këtë rast Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Zeqiri theksoi “Duke vlerësuar lartë angazhimin tuaj ndër vite në funksion të kësaj kauze, dëshirojmë ta dëshmojmë dhe të zotohemi që edhe ne si kompani do të punojmë edhe më shumë në arritjen e barazisë gjinore. Gratë luajnë një rol të rëndësishëm në pozitat menaxheriale brenda sektorit të energjisë sepse promovimi i një ambienti të punës më gjithëpërfshirës, është provuar që ofron rezultate më të mira dhe të qëndrueshme”.

Angazhimi dhe kontributi i institucioneve të Kosovës, qenësor për të shmangur mosbalancën e theksuar të energjisë elektrike në vend

Në mars 2023, përfaqësuesit e RGCE, Laurent Rosseel dhe Albino Marques, zhvilluan takime në Republikën e Kosovës për diskutuar sfidat në sektorin e energjisë. Delegacioni i udhëhequr nga Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT, Evetar Zeqiri dhe Kryesuesi i Bordit Jeton Mehmeti morën pjesë në takime me akterët kryesorë të sektorit energjetik, ku u informuan rreth vështirësive që përballen KOSTT, duke përfshirë devijimet nga konsumi i paligjshëm në pjesën veriore të Kosovës dhe mungesën e prodhimit të mjaftueshëm. Kryeparlamentari Glauk Konjufca theksoi rëndësinë e zbatimit të Udhërrëfyesit për Marrëveshjet e Energjisë me Serbinë dhe bëri thirrje për presion ndaj Serbisë për implementim të plotë. Ministja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, paraqiti masat e Qeverisë për sigurimin e furnizimit të energjisë elektrike dhe subvencionimin e efikasitetit të energjisë për qytetarët. Zyra e Rregullatorit të Energjisë dhe Korporata Energjetike e Kosovës shprehen gatishmërinë për bashkëpunim në zgjidhjen e sfidave të sektorit të energjisë.

KOSTT i bashkohet kampanjës globale Përqafojmë barazinë gjinore

Në mënyrë që të Përqafojmë Barazinë gjinore, KOSTT do të vazhdojë të punojë deri në integrimin e plotë të barazisë institucionale, për të mundësuar pjesëmarrjen në vendimmarrje të sa më shumë grave në kompaninë tonë dhe të ofrojmë një ambient pune të barabartë dhe jodiskriminues, duke kontribuar kështu në një shoqëri më të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.

Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT pjesë e Konferencës “Sfidat e Energjisë drejt Tranzicionit dhe Qëndrueshmërisë”

Në Tiranë është zhvilluar Konferenca “Sfidat e Energjisë drejt Tranzicionit dhe Qëndrueshmërisë” nën organizim të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të Shqipërisë, Foreign Investors Association of Albania – FIAA dhe EU Strategy for the Adriatic and Ionian Region (EUSAIR), për të diskutuar diversifikimin e burimeve të energjisë së ripërtëritshme dhe perspektivat e tregut rajonal për tranzicion dhe qëndrueshmëri në sektorin

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 26 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

e energjisë. Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT-it, z. Evetar Zeqiri, mori pjesë në panelin me temë "Modeli i Tregut të Energjisë, Operatorët dhe Pjesëmarrësit" ku ndër të tjera theksoi nevojën për investime në transmision për të mbështetur objektivat e strategjisë së energjisë në Kosovë.

Menaxhmenti i lartë i KOSTT-it priti në takim Zëvendës Ambasadorin e Republikës Federale Gjermane z. Conrad

Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT-it, z. Evetar Zeqiri me bashkëpunëtorë kanë pritur në takim zëvendës Ambasadorin e Republikës Federale Gjermane z. Matthias Conrad, i shoqëruar nga z. Moritz Reme, Drejtor i zyrës së KfW për Kosovë dhe znj. Ganimete Huruglica zv. Drejtore e zyrës së KfW për Kosovë, të cilët u njoftuan në lidhje me operimin e përgjithshëm të Sistemit të Transmetimit të Republikës së Kosovës, si dhe u prezantuan kapacitetet e Rrjetit të Transmetimit, zhvillimi i tregut të energjisë elektrike si dhe aktivitetet e ardhshme drejt objektivave të Strategjisë së Energjisë.

Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT priti në takim Shefin e Zyrës për Kosovë të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT-it, z. Evetar Zeqiri me bashkëpunëtor priti në takim Shefin e Zyrës së Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim në Kosovë z. Sergiy Masclchenko, Drejtorin Regjional për Energji, z. Francesco Corbo dhe z. Bekim Muharremi. Mundësitë e rritjes së bashkëpunimit për mbështetjen e mëtutjeshme të KOSTT në realizimin e projekteve të planifikuara në kuadër të Planit Investiv dhe rritja e fleksibilitetit të sistemit dhe krijimit të kushteve të përshtatshme për integrimin e Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë në Sistemin Elektroenergjetik të Kosovës ishin temë kryesore e këtij takimi

KOSTT prezanton rezultatet e arritura në tryezën e rrumbullakët për barazinë gjinore në sektorin e energjisë

Nën organizim të Ministrisë së Ekonomisë, në tryezë të rrumbullakët për barazinë gjinore në sektorin e energjisë në Kosovë, e cila fokus kryesor kishte zhvillimin dhe fuqizimin e mëtutjeshëm të barazisë gjinore në institucionet publike, përmes programit për integrim intensiv gjinor, implementuar nga Engendering Industries/USAID, KOSTT ishte e ftuar në cilësinë e shembullit më të mirë në vend në sektorin e energjisë për të prezantuar arritjet dhe rezultatet e ndërmarra në hapa konkrete për adresimin e barazisë gjinore.

Prill 2023

Jetësohet projekti për operimin e Bursës Shqipëtare të Energjisë përmes ankandit të parë të tregut një ditë para në Shqipëri

Në prill u mbajt ceremonia e hapjes së ankandit të parë të tregut të energjisë një ditë para të Bursës Shqiptare të energjisë ALPEX për zonen e ofertimit të Shqipërisë ku morën pjesë figura të larta shtetërore dhe të institucioneve relevante të sektorit të energjisë elektrike nga Kosova dhe Shqipëria, dhe u lansua edhe një nga projektet më madhore në drejtim të bashkimit të tregjeve të energjisë Kosovë-Shqipëri. Në këto momente të rendësishme jo vetëm për sektorin e energjisë por edhe për të dyja shtetet, në cilësinë e aksionarit të ALPEX, menaxhmenti i lartë i KOSTT në krye me Kryeshefin Ekzekutiv dhe Kryesuesin e Bordit të Drejtorëve,

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 27 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

falënderuan Qeverinë e Kosovës dhe atë të Shqipërisë për përpjekjet dhe mbështetjen e vazhdueshme për jetësimin e këtij projekti.

Maj 2023

Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT priti në takim ekipin për energji të Bankës Botërore

Për të diskutuar axhendën e tranzicionit të drejtë dhe zhvillimin e kapaciteteve të energjisë së rinovueshme në Kosovë, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT-it, z. Evetar Zeqiri me bashkëpunëtor priti në takim ekipën për energji të Bankës Botërore të kryesuar nga z. Rhedon Begolli, znj. Katharina Gassner dhe znj. Zuzana Dobrotkova. Integrimi i burimeve të rinovueshme të energjisë në rrjetin transmetues, transpozimi i rregulloreve teknike të pakos së re të energjisë elektrike, si dhe integrimi në tregun rajonal të energjisë elektrike ishin ndër temat e diskutuara.

KOSTT mirëpret në vizitë një grup të studentëve të fushës së energjisë

Në kuadër të bashkëpunimit tashmë shumë vjeçar me #KOSTT, studentët e Fakultetit të Inxhinierisë së Energjisë pranë UBT, realizuan vizitë studimore në Nënstacionin 110/35/10 kV Prishtina 1, ku u njoftuan për së afërmi me funksionimin e nënstacionit si dhe stabilimenteve të nivelit të tensionit të lartë

U nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit në mes të KOSTT sh.a Kosovë dhe ELES d.o.o Slloveni

Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT-it, z. Evetar Zeqiri, dhe Zv. Kryeshefi Ekzekutiv i ELES d.o.o, z. Jurij Klančnik, nënshkruan Marrëveshjen për Bashkëpunim ndërmjet dy kompanive gjatë vizitës së KOSTT në Operatorin e Sistemit dhe Transmisionit Slloven-ELES d.o.o. Marrëveshja synon shkëmbimin e njohurive dhe promovimin e bashkëpunimit në qeverisjen korporative, funksionimin e rrjetit, planifikimin, integrimin e tregut dhe zhvillimin e kapaciteteve. Delegacioni i KOSTT-it pati takime dhe prezantime nga drejtorët kyç të ELES d.o.o., duke përfshirë projekte inovative në transmision, teknologjinë e informacionit dhe sigurinë kibernetike.

Gatishmëria e rrjetit transmetues të KOSTT po mundëson akomodimin e kapaciteteve të reja të burimeve të ripërtëritshme

Nën organizim të Ministrisë së Ekonomisë dhe Agjencionit Amerikan për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) u mbajt Konferenca e Para-Ofertimit për Ankandin Solar 100 MW, ku u diskutuan roli dhe rëndësia e diversifikimit të burimeve të prodhimit të energjisë si dhe kapaciteteve të reja të energjisë nga burimet e ripërtëritshme, të cilat janë të kyçura apo pritet të kyçen në rrjetin e transmisionit. KOSTT tashmë kishte të instaluar 279 MW të gjenerimit të ripërtëritshëm në territorin e Republikës së Kosovës, e cila i ka dhënë përvojën në procesin e kyçjes së kapaciteteve të reja të ripërtëritshme, si dhe ndikimin e gjenerimit të ndryshueshëm të burimeve të ripërtëritshme në funksionimin e sistemit.

Qershor 2023

KOSTT kompani publike lidere në promovim të praktikave më të mira të Përgjegjësisë Shoqërore Korporative

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 28 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

Nëpërmjet përpjekjeve të vazhdueshme për të promovuar praktikat më të mira të Përgjegjësisë Shoqërore Korporative, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të fëmijëve, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Evetar Zeqiri dhe Drejtoresha Gjenerale e SOS Fshatrave në Kosovë znj. Nezahate Salihu, nënshkruan Marrëveshjen për Donacion përmes së cilës KOSTT dhuroi 400 orë pune në vlerë prej 5 eurove, në kuadër të kampanjës “Dhuro 1 orë pune, për 1 Qershor” e cila mundësoi sado pak mbështetjen e programeve të tyre thelbësore dhe njëherësh jemi kontribuesi më i madh i kësaj fushate.

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve pritëm fëmijët e punonjësve të KOSTT

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, u kujdesëm gjithashtu që fëmijët e punonjësve të KOSTT-it të vizitojnë vendin e punës së prindërve të tyre, ku përmes prezantimeve atraktive dhe aktiviteteve të ndryshme i njoftuam ata më për së afërmi me profesionet dhe funksionimin e KOSTT, në përpjekje për ta bërë këtë vizitë sa më interesante dhe një eksperiencë të paharrueshme për ta.

Në kuadër të pjesëmarrjes në Forum të Komunitetit të Energjisë në Athinë, u realizuan vizita në IPTO S.A dhe Grid Telecom

Në kuadër të pjesëmarrjes në Forum të Komunitetit të Energjisë, e realizuar në Athinë me datë 7 dhe 8 qershor 2023, delegacioni i KOSTT, kryesuar nga Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT-it z. Evetar Zeqiri, gjithashtu realizuan vizitë në Operatorin e Pavarur të Transmisionit të Energjisë së Greqisë- IPTO SA ku u pritën nga menaxhmenti i lartë në krye me z. Konstantinos Agathakis, Zyrtar Kryesor i Divizionit për Zhvillim dhe Transformim Digjital, z.Nikos Raftopoulos, Drejtor i Departamentit për IT dhe Telekom si dhe z.Haris Kotsokolos Drejtor Financiar me bashkëpunëtor nga GridTelekom. Gjatë takimit, trajtuan një mori e temave të rëndësishme me theks të veçantë në ato të qeverisjes korporative si dhe projektet e ndryshme të zhvillimit të rrjetit transmetues në perspektivë rajonale.

Fryma e re dhe kreativitetit në sektorin e energjisë u diskutua sot me delegacionin e programit Kompakt të MCC

Për të avansuar edhe më tutje sektorin e energjisë në vend, përmes praktikave ndërkombëtare të drejta dhe të barabarta, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Evetar Zeqiri me bashkëpunëtor, priti në takim ekipin ndërkombëtar nga Millenium Challenge Corporation-MCC dhe të Projektit JETA (Just and Equitable Transition Acceleration Project) i programit Kompakt me MCC, në përbërje të Znj. Jozefina Cutura - Përfshirja Gjinore dhe Sociale MCC, z. Koby Amponsah - Monitorim dhe Vlerësim MCC, z. Mitzi Hanold - Zhvillim i Kapitalit Njerëzor MCC, z. Andreas Meyn - Konsulent për Fuqi Punëtore, z. Janna Fortmann - Lidere e Ekipit të TetraTech (Aktiviteti i Përfshirjes Gjinore - Projekti JETA) dhe z. Gramos Buçinca - Projekti JETA.

KOSTT shënoi Ditën Ndërkombëtare të Grave në Inxhinieri

Me synim të përkrahjes dhe fuqizimit të mëtutjeshëm të punonjësve të kompanisë sonë si dhe për të vlerësuar lartë kontributin dhe rolin e gruas në sektor të energjisë edhe këtë vit I jemi bashkuar iniciativës ndërkombëtare International Women in Engineering Day/Dita Ndërkombëtare e Grave në Inxhinieri INWED,

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 29 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

e cila shënoi 10 vjetorin e fillimit të kësaj iniciative globale. Në përmbushje të objektivave të Strategjisë Kombëtarë të Energjisë e cila parasheh ngritjen e numrit të grave të punësuar në sektorin e energjisë nga 9% në 25 %, në bashkëpunim edhe me parterët tanë ndërkombëtar KOSTT do të kontribuoj edhe më tutje në zvogëlimin e hendekut të të punësuarve në sektor të energjisë.

Korrik 2023

Agjencioni i Francës për Zhvillim dhe Ekspertizë Franceze vizituan KOSTT

Për të diskutuar axhendën e tranzicionit të drejtë dhe zhvillimin e kapaciteteve të energjisë së rinovueshme në Kosovë. Në kuadër të takimit, është diskutuar për mundësitë e vendosjes së bashkëpunimit për mbështetje të KOSTT në realizimin e projekteve të planifikuara në kuadër të Planit Investiv, si dhe integrimin e burimeve të energjisë së rinovueshme në rrjetin transmetues. Po ashtu u trajtua edhe tema e transpozimit të rregulloreve teknike të pakos së re të energjisë elektrike, përfshirë edhe temat si digjitalizimi i nën-stacioneve, siguria kibernetike dhe tema tjera me interes të përbashkët.

Gusht 2023

Vizitë nga Fondi Monetar Ndërkombëtar në Kosovë (FMN)

Të udhëhequr nga z. Mark A. Horton zv. Drejtor për Departamentin Evropian dhe z. Gabriel Di Bella Shef i Misionit të FMN-së për Kosovën dhe ekipin e tyre, kanë vizituar KOSTT ku janë pritur nga Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Evetar Zeqiri dhe Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve z. Jeton Mehmeti. Zhvillimet kryesore në sektorin e energjisë në vend dhe në KOSTT, ishin temat kyçe të diskutuara gjatë këtij takimi. Një ndër çështjet thelbësore të diskutuara, ishte statusi aktual i fillimit të operimit të tregut të energjisë elektrike në zonën e ofertimit në Kosovë për tregun një ditë para dhe bashkimit të tregjeve në kuadër të Bursës Shqiptare të Energjisë ALPEX.

KOSTT dhe Komuna e Dragashit kanë nënshkruar kontratë për shfrytëzim të pronës për ndërtimin e Nënstacionit në Dragash

Me synim për zhvillimin e vazhdueshëm të Sistemit të Transmetimit të Republikës së Kosovës, KOSTT ka filluar përgatitjet për realizimin e investimit kapital për ndërtimin e nënstacionit të ri 110/35/10(20)kV Dragash, i cili bashkë financohet nga Banka Gjermane për Zhvillim -KfW. Në këtë drejtim, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Evetar Zeqiri ka nënshkruar kontratë me Kryetarin e Komunës së Dragashit z. Bexhet Xheladini, për shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale për ndërtimin e nënstacionit të ri 110/10(20)kV me linjat transmetuese 110kV

Shtator 2023

Ambasadori i Finlandës Sh.T.Z Nissinen ka vizituar Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Tregut-KOSTT sh.a.

Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Evetar Zeqiri me bashkëpunëtor kanë pritur në vizitë Ambasadorin e Finlandës në Kosovë Sh.T.Z. Matti Nissinen ku u njoftua me punën e ndërmarrjes zhvillimet e fundit dhe sfidat në KOSTT

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 30 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

dhe në sektor të energjisë. Ambasadori Nissinen ka shprehur gatishmërinë e shtetit Finlandez për të ofruar përkrahje me ekspertizën e tyre në integrimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë si dhe në fushat tjera siç janë ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe barazia gjinore dhe bashkë të dyja palët për vazhdim dhe intensifikim të bashkëpunimit në projekte të përbashkëta në të ardhshmen.

Nënshkruhet kontrata me Komunën e Malishevës për shfrytëzim të pronës për ndërtimin e Nënstacionit në Malishevë

Me qëllim të zhvillimit dhe modernizimit të Sistemit Transmetues të Republikës së Kosovës, është nënshkruar kontrata për shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale ndërmjet Kryeshefit Ekzekutiv të KOSTT z. Evetar Zeqiri dhe Kryetarit të Komunës së Malishevës z. Ekrem Kastrati, për ndërtimin e Nënstacionit të ri 220/35/10(20)kV Malisheva me linjën transmetuese 220kV. Ndërtimi I Nënstacionit të ri në Malishevë, përveç rëndësisë që e ka në përforcimin dhe zhvillimin e rrjetit të transmetimit, njëkohësisht krijon kushte për integrim dhe operim të sigurt të burimeve të ripërtëritshme të energjisë në atë rajon, e që janë objektiva afatgjate të politikave energjetike të vendit. Përveç kontratës për shfrytëzim të pronës, KOSTT ka kontraktuar kompaninë konsulente e cila do të bëjë përgatitjen e dokumentacionit ndërtimor projektues për NS 220/35/10(20)kV Malisheva me linjën transmetuese 220kV.

Ambasadori i Francës Sh.T.Z Guérot ka vizituar KOSTT

Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Evetar Zeqiri me bashkëpunëtor kanë pritur në takim Ambasadorin e Francës në Kosovë Sh.T.Z. Olivier Guérot, i shoqëruar nga znj. Cecilia Maronnier, Atashe për Bashkëpunim,

Ndërtimi i raporteve dhe bashkëpunimi ndërmjet institucioneve është thelbësore për nxitjen e zhvillimit të sektorit energjetik, dhe në vazhden e kësaj, të dyja palët ka shprehur gatishmërinë në fuqizim të mëtutjeshëm të partneritetit ndërmjet institucioneve.

KOSTT ka nënshkruan Letër Bashkëpunimi me Iniciativën për Vetë-Fuqizim dhe Barazi për Ndryshim (SEE Change) të Universitetit Johns Hopkins

Në kuadër të programit të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar-USAID Engendering Industries (EI) të zbatuar nga Tetra Tech. Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Evetar Zeqiri ka nënshkruar Letër Bashkëpunimi me Iniciativën për Vetë-Fuqizimi dhe Barazi për Ndryshim (SEE Change) të Universitetit Johns Hopkins e përfaqësuar nga Dr. Anita Shankar, program ky i cili ka për qëllim të udhëzojë partneritetin dhe bashkëpunimin mes palëve në lidhje me zbatimin e Programit të Trajnimit për Fuqizimin e Punonjësve (EETP).

Tetor 2023

Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Evetar Zeqiri me bashkëpunëtor, ka inspektuar punimet që realizohen në finalizimin e projektit për Ndërtimin e Nënstacionit 110/35/10(20)kV Ferizaj 3 si dhe punimet në vazhdim në Nënstacionin 110/35/10(20)kV në Fushë Kosovë

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 31 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

Me investimet e realizuara në këto nënstacione sipas teknologjisë së fundit GIS, mundësohen kushte për zhvillim të mëtutjeshëm ekonomik në këto komuna si dhe rrisim sigurinë e furnizimit të energjisë elektrike nga aspekti i transmetimit.

Delegacioni gjerman në krye me zv. Ambasadorin e Republikës Federale Gjermane z. Conrad kanë vizituar KOSTT.

Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Evetar Zeqiri me bashkëpunëtorë kanë pritur në takim zëvendës Ambasadorin e Republikës Federale Gjermane z. Matthias Conrad, i shoqëruar nga z. Moritz Reme, Drejtor i zyrës së KfE për Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, znj. Ganimete Huruglica zv. Drejtore e zyrës së KfW për Kosovë si dhe znj. Nora Hasani Drejtoreshë e Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare. z. Zeqiri vlerësoi bashkëpunimin financiar ndër vite me KfW, duke theksuar nevojën për ratifikim të Marrëveshjes për kredi në vlerë 25.5 milion € (Faza VII) për zhvillimin dhe modernizimin e Sistemit të Transmetimit, e cila është duke pritur prej kohësh për t'u ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Kjo kredi është jetike dhe parasheh investime kritike që do të përmirësonin sigurinë e furnizimit dhe krijimit të kushteve më të mira për integrimin e burimeve të ripërtëritshme. Zëvendës Ambasadori Conrad theksoi rëndësinë që KOSTT të shlyejë obligimet ndaj ENTSO-E, të sigurojë balancimin e sistemit dhe të reduktojë devijimet në minimum. Ata diskutuan gjithashtu pengesat burokratike për investitorët e mundshëm në sektorin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë.

KOSTT shënoi Tetorin Rozë

Në përmbyllje të Tetorit Rozë- muajit për ndërgjegjësimin e kancerit të gjirit dhe për të ngritur njohuritë e punonjëseve të kompanisë, është realizuar një ligjëratë nga Prof. Dr. Shqiptar Demaçi- Kirurg Torakal dhe i Gjirit, me qëllim informimin e grave rreth sëmundjes së kancerit të gjirit, simptomat dhe identifikimin në fazë të hershme. Për të nxitur ndërgjegjësimin Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Evetar Zeqiri, mundësoi punonjëseve të KOSTT shfrytëzimin e një ditë të lirë në mënyrë që të kujdesen për shëndetin e tyre përmes kontrolleve të nevojshme.

Nëntor 2023

KOSTT në bashkëpunim me Bankën Botërore kanë organizuar takimin e fundit të vitit i cili u mbajt për herë të parë në Prishtinë, Kosovë. Kjo ngjarje ka shërbyer si platformë për të shpalosur dhe diskutuar gjetjet e fazës së parë të asistencës teknike të udhëhequr nga Banka Botërore dhe e cila është pjesë e EIBIF - Korniza e Investimeve në Ballkanin Perëndimor. Me këtë rast, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT, z. Evetar Zeqiri, ka theksuar se Autostrada Digjiale Ballkanike nuk është thjeshtë një koleksion infrastrukture fizike, por një dëshmi e fuqisë së bashkëpunimit, inovacionit dhe vizionit të përbashkët.

Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit për Bashkimin e Tregut të Ditës në Avancë të Energjisë Elektrike në Evropën Juglindore.

Nën iniciativën e Agjencionit Amerikan për Zhvillim Ndërkombëtar USAID dhe mbështetur nga National Association of Regulatory Utility Commissioners - NARUC U.S. Energy Association –USEA dhe RTIInternational, në Athinë të Greqisë, është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit për Bashkimin e Tregut të Ditës në Avancë të Energjisë Elektrike në Evropën Juglindore. Krerët e Autoriteteve Rregullative, Operatorëve të

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 32 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

Sistemit të Transmetimit dhe Bursave të Energjisë Elektrike nga Kosova, Shqipëria, Greqia dhe Maqedonia e Veriut, si palë me rol kyç në tregun e energjisë elektrike në Evropën Juglindore (EJL), kanë nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi me synimin për themelimin e një bashkëpunimi të qëndrueshëm, drejtë arritjes së objektivave të përbashkëta të rajonit, duke rritur sigurinë e furnizimit dhe siguruar pjesëmarrje të përbashkët, në përputhje me praktikatat dhe modelet më të mira evropiane.

Rraportimi i Bordit të Drejtorëve dhe Menaxhmentit të lartë të KOSTT

Në Komisionin për Buxhet, Punë dhe Transfere, është shqyrtua Raporti Vjetor i KOSTT për vitin 2022. Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve z. Jeton Mehmeti së bashku me Kryeshefin Ekzekutiv z. Evetar Zeqiri kanë prezantuar Raportin Vjetor dhe arritjet kryesore për vitin 2022. Gjatë raportimit është theksua që përkundër sfidave unike që është përballur KOSTT viteve të fundit, si mungesa e një zgjidhje të qëndrueshme financiare për mbulimin e humbjeve në katër komunat veriore, mirëmbajtja e marrëveshjes së kyçjes me ENTSO-E, gjithashtu u përmenden një sërë arritjesh pozitive gjatë vitit 2022, përfshirë përmbylljen e vitit me bilanc pozitiv financiar dhe , opinion të pa kualifikuar nga auditori i jashtëm për pasqyrat financiare të vitit 2022.

Konferenca e II-të e Komitetit Nacional CIGRE Kosova

-Kryeshefi Ekzekutiv z.Evetar Zeqiri, ka qenë pjesë e panelit të parë ku para të pranishmëve ka prezantuar të arriturat dhe punët e realizuara të cilat ndikojnë në akomodimin e kapaciteteve të reja në rrjetin transmetues të Kosovës dhe në përmbushje të objektivave të Strategjisë shtetërore të Energjisë.

Dhjetor 2023

Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Evetar Zeqiri në shoqëri të Kryetarit të Komunës së Podujevës z.Shpejtim Bulliqi kanë vizituan Nënstacionin në Komunën e Podujevës

Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Evetar Zeqiri ka realizuar vizitën në Nënstacionin e Podujevës dhe gjatë kësaj vizite po ashtu është pritur në një takim të hapur dhe miqësor nga Kryetari i kësaj Komune z.Shpejtim Bulliqi. Gjatë takimit z.Zeqiri dhe z.Bulliqi kanë biseduar për sfidat dhe mundësitë në fushën e energjisë si dhe forcimin e bashkëpunimit dhe zhvillimin e projekteve të përbashkëta për të përmirësuar infrastrukturën energjetike në Komunën e Podujevës.

Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT ka prezantuar vizionin për Sigurinë Energjetike dhe Bashkimin e Tregjeve të Energjisë në ngjarjen e Odës Ekonomike Amerikane

Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Evetar Zeqiri, në cilësinë e folësit në panelin e diskutimeve me temën “Siguria Energjetike - Rëndësia e Bashkimit të Tregut të Energjisë Elektrike mes vendeve të rajonit të Evropës Juglindore.

Akordohet kredia e tretë nga Qeveria Gjermane për zhvillimin e Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike, përmes Bankës Gjermane për Zhvillim

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 33 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

Në hapësirat e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Evetar Zeqiri dhe Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve z. Hekuran Murati, në prani të zëvendës Ambasadorit të Ambasadës së Republikës Federale Gjermane Z. Matthias Conrad, zëvendës Ministrit për Ekonomi z Getoar Mjeku dhe znj. Ganimete Huruglica zv. Drejtore e zyrës së KfË për Kosovë, kanë nënshkruar Marrëveshjen për Nën-huazim për Projektin “Zhvillimi i sektorit të energjisë Faza VII – Përmirësimi i Rrjetit të Transmetimit”, përmes së cilës do të bëhet financimi i një sërë projekteve të radhës për zhvillimin dhe modernizimin e infrastrukturës së transmetimit të energjisë elektrike në Kosovë. Me rastin e nënshkrimit të Marrëveshjes për Nën-huazim, Marrëveshja parasheh sigurimin e kredisë komerciale afatgjate nga KfË me kushte kredituese të buta në vlerë prej € 25,5 milion. KOSTT paralelisht me këtë projekt, ka paraqitur disa projekte për aprovim për grante tek dy institucione kredibile si Korniza e Investimeve të Ballkanit Përendimor (ËBIF) dhe Fondet për Instrumentin e Para-Antarësimit (IPA) në vlerë prej rreth 25 milion, që do t’i bashkohen kësaj pako investive.

KOSTT në Mbështetje të Talenteve vajza në Inxhinieri

Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT Z. Evetar Zeqiri, Dekani i FIEK - Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike– Prof.Asoc. Dr. Isak Shabani, dhe Women in Energy and Mining "Gratë në Energji dhe Miniera" (ËEM) – znj. Shqipe Neziri Vela, nënshkruan Memorandum Mirëkuptimi për ndarjen e 10 bursave vjetore për vajzat të cilat ndjekin studimet në fushat e ndryshme të Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike. Kjo Marrëveshje është një hap tjetër drejt angazhimit të KOSTT në avancimin e diversitetit dhe rritjen e rolit të grave në sektorin e energjisë është.

Nënshkruhet Kontrata për Shërbimet e Rezervës Manuale për Restaurimin e Frekuencës për vitin 2024

Me qëllim të operimit stabil të sistemit elektroenergjetik si dhe balancimit të sistemit në kohë reale, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT, z. Evetar Zeqiri, dhe Administratori i KESH, z. Ergys Verdho, kanë nënshkruar kontratën për shërbimet e Rezervës Manuale për Restaurimin e Frekuencës (mFRR). Vlera e kontratës arrin shumë rreth 7.1 milion euro për vitin 2024. Balancimi i sistemit në kohë reale është i parakusht i domosdoshëm për funksionimin normal të KOSTT si zonë rregulluese e pavarur, në kuadër të Bllokut Rregullues me Shqipërinë (Blloku AK) dhe në punë paralele me sistemet tjera të Evropës Kontinentale.

Me rastin e ndërrimit të motmotive Ministrja e Ekonomisë, Znj. Artane Rizvanolli, ka vizituar Qendrën Nacionale Dispečerike të KOSTT

Duke shprehur përkrahjen dhe vlerësimin e Ministrisë ndaj stafit kujdestar në këtë periudhë festash. Kryeshefi Ekzekutiv, z. Zeqiri ka potencuar se viti që po lëmë pas është ballafaquar me sfida unike të cilat janë tejkaluar me sukses edhe me mbështetjen e Qeverisë së Kosovës duke mundësuar integrim të plotë të të gjithë qytetarëve të vendit në sistemin elektroenergjetik të Kosovës. Ky ndërrim i motmotive është i veçantë pasi që po fillon një periudhë e re në sektorin e energjisë në Kosovë, që do t’i hapë rrugë fokusimit më të shtuar në zhvillimin e infrastrukturës elektroenergjetike, zhvillimit të tregjeve, integrimit të BRE-ve dhe sigurisë së furnizimit.

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 34 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

4. OPERIMI I SISTEMIT

4.1. Marrëveshja e Kyçjes (Connection Agreement) KOSTT – ENTSO-E

Pas shumë përpjekjeve, për të realizuar të drejtën e KOSTT që të operoj si Zonë Kontrolli e pavarur, fillimisht më 15.10.2015 KOSTT ka nënshkruar Marrëveshjen e Kyçjes (Connection Agreement) me ENTSO-E, mirëpo për shkak të problemeve politike nuk ka arritur që të aktivizohet në atë kohë.

Më pastaj, pas insistimeve tona të vazhdueshme, kjo marrëveshje, pra Connection Agreement KOSTT-ENTSO-E hyri në zbatim më 14 dhjetor 2020, dhe KOSTT ka filluar të operoj si Zonë Kontrolli Frekuencë-Fuqi (LFC Load-Frequency Control), brenda Bllokut Kontrollues (Control Block) AK (Albania – Kosovo).

KOSTT merrë obligime dhe njëkohësisht zotohet se të gjitha detyrat që dalin konform Rregulloreve të EU (EU Regulation), Kodeve të Rrjetit (Network Codes), Udhëzimeve (Guidelines) etj. ndaj ENTSO-E do të përmbushen.

ENTSO-E aktivizon grupin, të quajtur PG KOSTT (Project Group KOSTT), i cili përmes dokumentit të quajtur Catalogue of Measures, specifikon detyrat dhe obligimet që ka KOSTT-i të ndara sipas prioriteteve.

Operimi i Sistemit, në mënyrë permanente gjatë tërë vitit, ka punuar maksimalisht, duke bërë veprimet e nevojshme për të përmbushur këto detyra me prioritet siç janë: dimensionimi i rezervave, aktivizimi i rezervave, krijimi dhe dërgimi i fajllave Day Ahead Congestion Forecast (DACF), kalkulimet NTC etj.

4.2. Funkcionalizimi i Bllokut të Kontrollit (Control Block) AK – procedurat

Për të funksionalizur sa më me sukses Bllokun e Kontrollit AK, kanë vazhduar aktivitetet e grupeve punuese të përbashkëta KOSTT-OST. Janë përkujdesur për implementimin e procedurave punuese për fazat planifikuese dhe aplikimin në kohë reale:

- a) Metodologjia për Rregullat për dimensionimin e FRR në Bllokun LFC AK, dhe
- b) Procedura për shkëmbimin dhe aktivizimin e rezervave për balancim të zonave rregulluese dhe bllokut AK, e cila është duke u zbatuar në praktikë.

4.3. Krijimi dhe dërgimi i fajllave DACF (Day Ahead Control Files) në Swissgrid

Nga Operimi i Sistemit, çdo ditë pune, për 24 orë, krijohen fajllat DACF të cilët përfshijnë planifikimin e konsumit, gjenerimit, topologjinë e rrjetit, dhe importet/eksportet për Zonën e Kontrollit KOSTT. Këto fajlle, së pari dërgohen në OST, dhe më pas OST i dërgon në Swissgrid.

4.4. Kalkulimi i Net Transfere Capacities (NTC)

KOSTT ka nënshkruar marrëveshje bilaterale me OST (TSO e Shqipërisë), CGES (TSO e Malit të Zi) dhe me MEPSO (TSO e Maqedonisë) për vlerësimin e kapaciteteve transmetuese në kufirin përkatës. E njëjta gjë ende nuk është bërë me EMS (TSO e Serbisë), për shkak se EMS nuk ka shprehur interesim për këtë qështje.

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 35 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

Këto vlerësime bëhen në baza vjetore, mujore, dhe kur paraqitet nevoja edhe në baza javore dhe ditore. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur vlerësimet dhe kalkulimet e NTC-ve me TSO-të fqinje, vjetore dhe mujore:

Tabela 3. Vlerësimi i NTC

Vlerësimi i NTC (Net Transfer Capacity) për vitin 2023							
Vjetore:		KOSTT - OST	OST - KOSTT	KOSTT - MEPSO	MEPSO - KOSTT	KOSTT - CGES	CGES - KOSTT
		200	200	100	100	100	100
Mujore:		KOSTT - OST	OST - KOSTT	KOSTT - MEPSO	MEPSO - KOSTT	KOSTT - CGES	CGES - KOSTT
Janar 2023	01.01.-31.01.2023	400	400	400	400	300	200
Shkurt 2023	01.02.-28.02.2023	400	400	400	300	300	200
Mars 2023	01.03.-31.03.2023	400	400	400	250	300	200
Prill 2023	01.04.-30.04.2023	400	400	450	250	300	200
Maj 2023	01.05.-31.05.2023	400	400	400	250	300	200
Qershor 2023	01.06.-30.06.2023	400	400	350	350	300	200
Korrik 2023	01.07.-31.07.2023	400	400	350	350	300	200
Gusht 2023	01.08.-31.08.2023	400	400	350	350	300	200
Shtator 2023	01.09.-30.09.2023	400	400	350	350	300	200
Tetor 2023	01.10.-31.10.2023	400	400	450	450	300	200
Nëntor 2023	01.11.-30.11.2023	400	400	350	350	300	200
Dhjetor 2023	01.12.-31.12.2023	400	400	350	350	300	200

Vërejtje: Vlerat nga tabela e mësipërme kanë pasur ndryshime në disa data apo orë të caktuara në rastet kur ka pasur shkycje të planifikuara të linjave të interkoneksionit.

Pas kalkulimit të NTC-ve për secilin kufi, për të gjitha afatet kohore (time frames), këto vlera dërgohen në SEE CAO (Coordinated Auction Office in South East Europe (SEE CAO) me seli në Podgoricë / Mali i Zi, të cilat mund të shihen në linkun e mëposhtëm: <https://www.seecao.com/>

SEE CAO kryen alokimin explicit të kapaciteteve transmetuese ndërkufitare ndërmjet Operatorëve të Sistemit të Transmetimit aksionar dhe Përdoruesve të Shërbimeve (Service Users).

4.5. Publikimi i të dhënave në Platformën e Transparencën në ENTSO-E

Duke u bazuar në detyrat që dalin nga EU Regulation 543/2013 (COMMISSION REGULATION 543/2013 on submission and publication of data in electricity markets) ndaj ENTSO-E, për publikimin e të dhënave në Platformën e Transparencës, KOSTT ka për detyrë të publikoj të gjitha të dhënat relevante energjetike.

Operimi i Sistemit, në bashkëpunim edhe me Operatorin e Tregut, ka implementuar me sukses projektin për publikimin e të dhënave tona në Platformën e Transparencës të ENTSO-E, me ofruesin e këtij shërbimi Novita, të cilat mund të shihen online nga ENTSO-E Platforma e Transparencës, në linkun e mëposhtëm: <https://transparency.entsoe.eu/dashboard/show>


	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 36 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

Figura 2. <https://transparency.entsoe.eu/dashboard/show>

Këto të dhëna (ku disa nga to publikohen në ditën D – pas realizimit, e disa të dhëna të planfikuar-(javore, mujore, vjetore) vijnë nga të gjitha fushat: Ngarkesa (load), Gjenerimi (generation), Balancimi (balancing), Shkyçjet (outages), Transmisioni (transmission) etj.

4.6. Pergatitja e “.uct.” fajllave dhe participimi i KOSTT në modelin vjetor ‘Y-1’ (RGCE SG Network Models & Forecast Tools NMFT)

Operatori i Sistemit ka marrë pjesë dhe ka kryer detyrat që dalin nga grupi i ENTSO-E/RGCE për modelin vjetor Network Models ‘Y-1’. Kemi dërguar komisionimin/dekomisionimin e elementeve të sistemit për vitin 2023, krijimi i fajllave “.uct” të KOSTT-it për pesë skenare të caktuara për vitin 2023 nga ENTSO-E (Winter I, Spring, Summer, Autumn, Winter II), kalkulimi i lidhjeve të shkurtëra në nyjet ku lidhet gjenerimi për skenarët e caktuara. Ndërsa sfidë është dërgimi i ‘cgmes’ fajllave për dy skenarët e kërkuara nga ENTSO-E grupi i modelit të rrjetit, për arsye se momentalisht KOSTT nuk ka mundësi që të plotëson “boundary set” në bazën e të dhënave në ENTSO- E “NMD” (network modeling database).

4.7. Iniciativa e USEA/USAID e Bshkimit të Tregjeve (Market Coupling) në nivel regional të Europës Jug – Lindore (OST, KOSTT, MEPSO)

Në vitin 2023, KOSTT ka nënshkruar (së bashku edhe me palët tjera relevante) Memorandumin e Mirëkuptimit për Bashkimin e Tregut të Ditës në Avancë të Energjisë Elektrike në EJM, dhe është zotuar se do të ofrojë zonën e vet të ofertimit (Biding Zone) si dhe kufijtë e vet (cross-borders) në funksion të ndërtimit të mekanizmit të Tregut të harmonizuar dhe të integruar. Ky proces është në harmoni me kërkesat nga Paketa e Tretë e Energjisë (Third Energy Package), si dhe rregullativat CACM EU. Përmes kësaj iniciative synohet që KOSTT të aderohet dhe të participojë në Bashkimin e Tregut të Ditës në Avancë (SDAC – Single Day Ahead Market Coupling). Ekspertët nga EliaGrid International së bashku me USEA/USAID, kanë filluar bërjen e Analizës së Gap-it (Gap Analyses) për secilën TSO nënshkruese të MeM, për KOSTT, OST dhe MEPSO, me qëllim të identifikimit të mangësive (boshllëqeve) aktuale, e që lidhen me procesin e Bashkimit të Tregjeve. KOSTT ka marrë pjesë aktive në këto procese, të cilat janë duke vazhduar.

4.8. Verifikimi i Rregullt dhe Certifikimi i njëhësorëve sipas kërkesave të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2022

Gjatë vitit 2023 është arritur që të realizohet Verifikimi Periodik dhe Certifikimi i rreth 80 copë njëhësorëve që kanë qenë të instaluar në terren sipas kërkesave të Udhëzimit Administrativ (UA) Nr. 06/2022 për periudhën verifikuese periodike të pajisjeve matëse. Njëhësorët e verifikuar kanë qenë të instaluar në pika të ndryshme në rrjetin e transmetimit, në kufirin komercial në mes KOSTT dhe palëve tjera siç janë: Interkoneksion, gjenerim, distribucion, BRE, etj.

Realizimi i verifikimit të rregullt dhe certifikimi i këtyre njëhësorëve nënkupton që këta njëhësorë do të vazhdojnë të jenë në operim për shfrytëzim të mëtutjeshëm në rrjetin e transmetimit të KOSTT edhe për 8 vite (sipas UA Nr. 06/2022).

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 37 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

4.9. Testimi i njehsorëve për sistemet matëse në interkoneksion, gjenerim dhe distribuim

Gjatë vitit 2023 është arritur që të bëhet testimi i njehsorëve me etalon kl. 0.02 për pikat matëse në interkoneksion me qëllim të rritjes së besueshmërisë së operimit të sistemeve matëse sipas kërkesave të ENTSO-E. Në kuadër të kësaj, janë realizuar testimet e njehsorëve në të dyja anët e linjave interkonektive me OST, MEPSO dhe CGES, të cilat janë edhe obligimet që dalin nga marrëveshjet Inter TSO.

Gjithashtu, është realizuar Plani vjetor i testimit periodik të njehsorëve me instrument testues kl. 0.1 për pikat matëse në gjenerim dhe distribuicion sipas kërkesave të Kodit të Matjes.

4.10. Mbështetja me të dhëna orare nga sistemet matëse

Gjatë gjithë vitit 2023 në baza ditore është bërë mbështetja dhe shpërndarja e të dhënave matëse orare nga sistemet matëse tek palët brenda KOSTT-it, pastaj te Operatori i Tregut, te KEDS, KESCO, si dhe në Transparency Platform.

Për secilin muaj të vitit 2023 është llogaritur bilanci mujor i energjisë nga sistemet matëse me q'rast është përgatitur Raporti i Humbjeve teknike në rrjetin e transmetimit.

4.11. Pasqyrë e performancës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performances

4.11.1. Bilanci i planifikuar dhe i realizuar për janar-dhjetor 2023

Detyra e operimit të sistemit gjatë vitit 2023 ka qenë krijimi i kushteve për implementim të planeve paraprakisht të aprovuara të palëve tregtare sipas Bilancit 2023. Në vijim janë paraqitur disa të dhëna bazuar në analizën e bilancit të planifikuar dhe të realizuar për vitin 2023.

Vlerat janë sistemuar në formën tabelare për periudhën (janar-dhjetor) 2023, ku vlerat e planifikuara dhe të realizuara janë paraqitur në sasi të MWh, si dhe është treguar përqindja e realizimit në raport me planin për periudhën relevante.

Nga tabela vërehet se prodhimi vendor në nivelin e rrjetit të transmetimit ishte më i ultë se plani për 6,52%. Ka pasur zvogëlim të importit për 19,58 % dhe zvogëlim të eksportit për 50,73 % krahasuar me atë të planifikuar. Konsumi neto i Kosovës ka qenë më i ultë se plani për 1,50 %.

Humbjet në transmetim kanë qenë më të ulta për 14,06 % krahasuar me ato të planifikuara.

Gjatë kësaj periudhe, KOSTT mundësoi realizimin e të gjitha planeve të miratuara të palëve tregtare si prodhuesve TC KEK, HC Ujmani, HC Lumbardhi, Air Energy Kitka, Air energy Selaci, furnizuesit publik KESCO, konsumatorëve të mëdhenj të lidhur në rrjetin transmetimit Ferronikeli, Sharr Cem dhe Trepça. Pra nuk ka pasur ankesa në realizimin e kërkesave të palëve tregtare për shkak të rrjetit transmetimit.

Të dhënat e planifikuara janë paraqitur bazuar në dokumentin e Bilancit Vjetor të Energjisë Elektrike 2023 të miratuar nga ZRRE, ndërsa të dhënat e realizuara janë marrë nga pikat matëse dhe të transferuara në kufirin elektrik të rrjetit të transmetimit të Kosovës.

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	ver. 1.2	faqe 38 nga 144
Departamenti: Financiar dhe i Thesarit		Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik

Tabela 4. Bilanci i Energjisë Elektrike të planifikuara dhe të realizuara për vitin 2023

Muajt	Janar-Dhjetor 2023			
	MWh	E planifikuar	E realizuar	Real/Plan%
(1) Termo-gjenerimi		5 540 111	5 087 698	91.83
(1.1) TC Kosova A		2 550 892	2 111 258	82.77
(1.2) TC Kosova B		2 989 219	2 976 440	99.57
(2) Hidro-gjenerimi		191 250	191 435	100.10
(2.1) HC Lumbardhi		97 207	41 518	42.71
(2.2) HC Ujmani		94 043	145 295	154.50
(2.3) Hyrjet në transmetim nga ana 35kV (HC Hydroline)			4 622	
(3) Gjenerimi nga era		337 594	394 368	116.82
(3.1) PE KITKA		92 931	91 383	98.33
(3.2) PE Selaci (Sowi Kosova)		244 663	302 985	123.84
(4) = 1+2+3 Prodhimi në hyrje të Transmetimit		6 068 955	5 673 501	93.48
(5) Prodhimi i BRE në Shpërndarje		223 038	158 457	71.05
(6) Totali i shërbimeve ndihmëse			- 78 859	
(7) Devijimi			- 86 777	
(8) Eksporti		816 132	402 117	49.27
(9) Importi		1 545 866	1 243 128	80.42
(10) = 4+5-6-7-8+9 Energjia në disponim		7 021 727	6 838 605	97.39
(11) Kërkesa në Shpërndarje nga Transmetimi		5 685 624	5 542 192	97.48
(12)=12.1+12.2+12.3 Kërkesa e konsumatorëve të kyçur në Transmetim		344 530	246 308	71.49
(12.1) Ferronikeli		255 467	171 847	67.27
(12.2) Sharri		67 903	66 304	97.65
(12.3) Trepça nga Transmetimi			8 157	
Total konsumi i Trepçës*		21 160	20 329	96.07
(13)=13.1+13.2 Kërkesat për shpenzime të gjenerimit nga Transmetimi		257 338	444 074	172.56
(13.1) Mihjet - KEK		111 926	138 395	123.65
(13.2) Shpenzimet vetanake të gjenerimit nga Transmetimi (LP290,B1,B2,T12,T34,T35,T45, HC Lumbardhi, PE Kitka, PE Selaci)		145 411	305 679	210.22
(14) Humbjet për konsumin e Veriut		378 050	333 147	88.12
(15) = 11+12+13+14 Kërkesa neto (konsumi neto i dërguar nga Transmetimi)		6 665 542	6 565 722	98.50
(16) Humbjet në transmetim		133 147	114 426	85.94
(17) =15+16 Kërkesa gjithsej (konsumi Bruto i RK i dërguar nga Transmetimi)		6 798 690	6 680 148	98.26
(18)=5+17 Kërkesa e përgjithshme e sistemit të RK		7 021 727	6 838 605	97.39
(19) = 10 - 18 = 0 Saldo		0	0	

Disa prej të dhënave kryesore nga tabela 4 janë ilustruar edhe në diagramin në vijim, pra janë paraqitur kërkesa (konsumi), prodhimi neto i Kosovës, importi dhe humbjet teknike në rrjetin transmetues të Kosovës:




Figura 3. Bilanci i planifikuar dhe i realizuar 2023

Në vazhdim, është paraqitur figurativisht bilanci i shpërndarjes së gjithë energjisë elektrike që hynë në rrjetin transmetues të Kosovës drejt destinacioneve për periudhën janar-dhjetor 2023.





Figura 4. Bilanci i realizuar i energjisë elektrike në GWh janar-dhjetor 2023

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	ver. 1.2	faqe 40 nga 144
Departamenti: Financiar dhe i Thesarit		Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik

4.12. Indikatorët Kyç të Performancës - Operimi i Sistemit

Tabela 5. Indikatorët Kyç të Performancës - operimi i sistemit

Nr.	Indikator		Janar-Dhjetor 2022	Janar- Dhjetor 2023	2023/ 2022(%)	Caku	Komenti
T1	Koha mesatare e ndërprerjes (AIT minuta/periudhën e raportimit)		35.51	79.49	223.86	Caku vendoset sipas raportit: (AIT për periudhën aktuale)/(AIT për periudhën e kaluar) < 1	Koha mesatare e mos furnizimit të konsumatorëve për të cilën shkaktar ka qenë KOSTT, ka qenë më e lartë për 123.86% gjatë periudhës janar-dhjetor 2023, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022. Kjo ka qenë kryesisht për shkak të implementimit të projektit të AAC për ngjyrosjen e shtyllave dhe vendosja e sferave sinjalizuese.
T2	Numri i ankesave për tension		1	2		Nr i përgjigjeve / Nr ankesave =1	Caku për ankesa për tension duhet të ndërlihet me numrin e ankesave në vitin (et) paraprak në periudhën e njëjtë dhe mundësia e zgjidhjes së ankesës duhet

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 41 nga 144</i>
Siguria fizike në KOSTT, e cila nënkupton mbrojtjen e të gjitha asetëve të Kompanisë KOSTT nga kërcënimet me vjedhje apo dëmtime, gjatë vitit 2023 është arritur që asetet vitale të mbahen të pacenuara, përveç një rasti në NS Kosova B. Për arsye të situatës jo stabile të sigurisë fizike, rasteve të fundit të tentim-vjedhjeve (njëri me pasoja materiale) dhe situatës së rënduar rreth angazhimit të punëtorëve të sigurimit fizik, janë intensifikuar inspektimet nëpër objekte të KOSTT, me qëllim që të mos rrezikohet funksionimi i punës nëpër objekte dhe Nënstacione të KOSTT-it, të cilat do të mund të ndikonin në vazhdimësinë e punës. Në vazhdimësi janë ndërmarrë masa shtesë të sigurisë fizike në KOSTT, sidomos masa të cilat nuk kanë pasur ndonjë impakt financiar. Në realizim është kontrata kornizë për shërbime të sigurimit fizik.

Gjithashtu janë realizuar kontratat kornizë për furnizime si: furnizimi me material zyrtar, furnizim me material higjienik, mirëmbajtja e ashensorëve në NSQ, etj. dhe është në proces kontrata për furnizim me ujë të pijes për punëtorë të KOSTT.

Në vazhdimësi është punuar për përgatitjen e specifikimeve teknike të projekteve të mirëmbajtjes si "Realizimi i punëve të mirëmbajtjes në NS Klina, NS Vushtrria 1 dhe NS tjera", "Punimi i drenazhimit për SSH Glllogoci", "Mirëmbajtja dhe servisimi i aklimatizimit në dhomën e serverëve", "Ndarja e zyrës në katin 5", "Dizajni dhe realizimi i dollapit dhe murit pas monitorit në zyrën e KE", "Dizajni dhe realizimi i inventarit për Zyrën Ligjore", përgatitja e specifikimit dhe kërkesës për furnizim me karrige, përgatitja e specifikimit dhe kërkesës për Projektin "Furnizimi dhe instalimi i lexuesve të hyrja e garazhës në NSQ" etj.,

Janë bërë kontrollet e rregullta të sistemeve të ngrohjes dhe ftohjes si në Ndërtesën Qendrore ashtu edhe në Nënstacione. Është realizuar kontrata: Mbushja e sistemit me antifriz me punë përcjellëse, në vazhdimësi është bërë kontrollimi i pompave dhe këmbyesit, mbushja dhe ç'ajrosja e sistemit, kontrollimi dhe pastrimi i fancoilave në NSQ, kontrollimi i klimatizimit në dhomën e serverëve, si instalimi i klimave të reja të pajisjet në NS Prishtina 2 dhe NS Prizreni 3.

Një nga objektivat strategjike të KOSTT është edhe përkujdesi për shëndetin e punëtorëve, i cili është realizuar me projektin e sigurimit shëndetësor suplementar për të gjithë punëtorët edhe gjatë vitit 2023, meqenëse Ligji për sigurimet shëndetësor ende nuk është implementuar. Kjo ka ndikuar në mbajtjen e shëndetit të mirë të punëtorëve, në motivimin e punëtorëve për punë dhe arritjen e objektivës për të qenë punëdhënës atraktiv si dhe në ngritjen e kualitetit të punës dhe performancës së kompanisë në përgjithësi.

Në kuadër të kujdesit shëndetësor si kërkesë obligative ligjore me qëllim të përcjelljes permanente të gjendjes shëndetësore të punëtorëve, hyjnë edhe kontrollet sistematike mjekësore, ku gjatë vitit 2023, të gjithë punëtorët e KOSTT-it kanë realizuar kontrollet sistematike mjekësore.

Me qëllim të sigurisë dhe shëndetit të punëtorëve, KOSTT i kushton kujdes të veçantë, sigurisë së asetëve dhe menaxhimit mjedisor duke përbushur: furnizimin me pajisje mbrojtëse, informimin dhe përkrahjen gjatë

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 67 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

implementimit të dokumentacionit për zbatimin e procedurave për punë në mënyrë të sigurt gjatë mirëmbajtjes për linja, nënstacione dhe për kontraktues; inspektimin/monitorimin në teren të objekteve, aseteve, ekipeve të mirëmbajtjes dhe procesin gjatë realizimit të projekteve; largimin e materialeve të rrezikshme për shëndetin nga objektet ekzistuese; realizimin e matjeve të dëmtuesve fiziko-kimik, kushteve mikroklimatike dhe intensitetit të fushave elektromagnetike në vendin e punës; angazhimin mbi zhvillimin e projekteve për siguri dhe mjedis dhe sipas planit të buxhetit; zhvillimin dhe mirëmbajtjen e dokumentacionit për menaxhimin e sistemit të sigurisë dhe shëndetit në punë si dhe sistemin e menaxhimit të mjedisit konform rregullativës ligjore dhe kërkesave nga certifikimi me standardet ISO 14001 dhe ISO 45001; zhvillimi dhe mbajtja e programeve trajnuese për punëtorë; bashkëpunimi me institucionet qendrore dhe lokale etj.

KOSTT edhe gjatë vitit 2023, si edhe deri më tani, ka ofruar mbështetje për kryerjen e praktikës profesionale për student.

Me qëllim të përkrahjes financiare për studentët në sektorin e energjisë elektrike, KOSTT gjatë vitit 2023 ka ndare 10 bursa për studentë të Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike për vitin akademik 2023/2024.

Në përkrahje të personave me aftësi të kufizuar është lidhur marrëveshja mes KOSTT – Down Sindrom Kosova për angazhimin e një anëtarit të Shoqatës Down Sindrom Kosova në KOSTT. KOSTT do të angazhohet në këtë drejtim edhe në vitet në vazhdim.

Ka vazhduar Programi i Përshpejtuar i Barazisë Gjinore në vendin e punës financiar nga USAID dhe implementuar nga Tetrattech, në të cilin menaxherët, udhëheqesit dhe kompanitë në Industrinë e dominuar nga meshkujt mund të përdorin këtë program dhe praktikën më të mirë për të avancuar barazinë gjinore në vendë pune. Në kuadër të programit përfaqësuesit e KOSTT për barazi gjinore kanë marrë pjesë në trajnimin e organizuar në Bruksel, i cili është fokusuar në: identifikimin e boshllëqeve të barazisë gjinore brenda organizatës, zhvillimi/krijimi i një rast biznesi që do të demonstroi se si barazia gjinore do të përfitojë në kompani, ndërmarrja e veprimeve të synuara, të prekshme dhe strategjike, të bazuara në vlerësim, për të rritur barazinë gjinore në kompani, zhvillimi dhe forcimi i aftësive udhëheqese, ndryshimit të menaxhimit dhe mënyrën e ushtrimit të ndikimit për të krijuar një vend pune të barabartë dhe të larmishëm për të gjithë, etj. Me qëllim të promovimit të barazisë gjinore, ekipi për barazi gjinore ka prezantuar pjesë të programit për stafin e KOSTT-it, mbështetur edhe në Politikën për barazi gjinore dhe Politikën për shqetsimin në vendin e punës.

8. REALIZIMI I PROJEKTEVE KAPITALE GJATË VITIT 2023

Gjendja globale ekonomike dhe Energjetike e paraqitur në fillim të vitit 2022 ka reflektuar edhe në vitin 2023 në realizimin e investimeve kapitale të parapara me planin investiv 2023-2027, e të aprovuar nga ZRrE.

KOSTT gjatë vitit 2023 ka bërë përpjekje maksimale në finalizimin e projekteve të filluara me implementim konform planit investiv 2018-2022 dhe fillimin e realizimit të projekteve të reja 2023-2027 (sipas periudhës tarifore), dhe buxhetit të aprovuar për vitin 2023.

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 68 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

Sa i përket investimeve në sistemin e transmetimit, projektet e filluara me realizim janë të kategorisë së :

- Përkrahjes së ngarkesës/nënstacionet e reja 110/35/10(20)kV ; dhe
- Përforcimin e kapaciteteve ekzistuese transformuese dhe transmetuese.

8.1. Projektet e menaxhuara nga Departamenti për Zhvillimin e Rrjetit dhe Projekteve janë të paraqitura në bazë të kategorive si më poshtë:

I. Projekti i cili në vitin 2023 ka përfunduar teknikisht dhe financiarisht dhe është në afat garantues njëvjeçar:

- **Ndërtimi i NS. 110/35/10(20) kV Ferizaji 3 me transformator 40MVA – Kastrioti**

Projekti ka përfunduar me kohë dhe sipas buxhetit.

Funksionalizimi i nënstationit është i ndërlidhur me Projektin “Ndërtimi i linjës/kabllos 110kV për kyçe të nënstationit të ri 110/35/10(20) kV Kastrioti LOT 5”, pasi procesi i ndërtimit të linjës është vonuar, për shkak të pezullimit nga MMPHI, si rezultat i disa ankesave në gjykatë nga pronarët e tokave.

II. Grupi tjetër i projekteve të financuara nga KOSTT, ku kontrata është nënshkruar gjatë vitit 2021/2022 dhe janë në fazën e implementimit:

- **Ndërtimi i NS të ri GIS. 110/35/10(20) kV Fushë Kosova**

Kontrata për projektin është filluar në janar 2022 dhe pritet të përfundoj në janar 2024. Projekti po realizohet sipas kontratës me kohë dhe buxhet. Në bazë të protokollit të punëve të kryera deri në fund të vitit 2023 në total janë përfunduar diku rreth 90% e punëve.

- **Ndërtimi i linjës/kabllos 110kV për kyçe të nënstationit të ri 110/35/10(20) kV Kastrioti**

Projekti është nënshkruar në maj 2021 dhe ishte paraparë të përfundoj në maj 2023. Konform kontratës dhe ligjeve në fuqi janë realizuar detyrat për aplikim në MMPH për marrje të lejës ndërtimore dhe shpronësimit e servitutës. Mos zgjedhja e çështjeve pronësoro juridike dhe proceseve gjyqësore të ankesave nga tre pronar për trasen e linjës, ka shkaktuar vonesa në realizimin e projektit . Në nëntor të vitit 2023, është marrë leja e ndërtimit dhe kontraktori ka filluar punën e realizimit të projektit. Pritet që projekti të përfundoj në verën e vitit 2024, varësisht nëse ska pengesa pronësore.

III. Projektet e financuara nga KOSTT dhe të tenderuar gjatë vitit 2023

Për shkakë të situatës globale të krijuar dhe rritjes së çmimeve në treg, projekti i më poshtëm i tenderuar sipas buxhetit të vitit 2022 ka dështuar (të ofertave me çmime më të larta), dhe në vitin 2023 pas aprovimit të Planit Investiv 2023-2027 projekti është ritenderuar dhe është në prokurim:

- **Përgaditja e dokumentacionit ndërtimor projektues për NS 220/35/10(20) kV Malisheva**

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 69 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

Me datën 30.08.2023 është nënshkruar kontrata ndërsa fillimi i shërbimeve në bazë të kontratës është 10 ditë nga data e nënshkrimit, data e fillimit 11.09.2023. Projekti është duke u zhvilluar sipas kohës dhe buxhetit. Projekti pritet të përfundoj në prill të vitit 2024.

Në formë tabelare më poshtë mund të gjeni përshkrimin e progresit dhe realizimit të projekteve kapitale të realizuara nga Departamenti për Zhvillim të Rrjetit dhe Projekteve gjatë vitit 2023

Tabela 13. Realizimi i buxhetit të projekteve kryesore kapitale gjatë vitit 2022

1.	Ndërtimi i NS. 110/35/10(20) kV Kastrioti
Buxheti	4,956,000.00 €
Financues	KOSTT
Vlera e kontratës	4,701,015.97 €
Data e fillimit	Maj 2021
Data e përfundimit	Maj 2023
Kontraktues	Hitachi Energy Zagreb d.o.o.
Buxheti i shpenzuar total	4,676,285.68 €
Buxheti i shpenzuar gjatë vitit 2023	1,936,639.21 €
Statusi aktual i projektit	Projektit aktualisht është realizuar në kohë dhe brenda buxhetit dhe është në afatin garantues
Realizimi:	(i) Progresi Projekti “Nënstacioni NS110/35/10(20) kV Kastrioti” është financim nga buxheti i KOSTT-it, Është nënshkruar kontrata më 31.03.2021, ndërsa me pas në maj 2021, është paguar avansi që është edhe fillimi efektiv i kontratës, Marrja e lejës ndërtimore nga MMPHI me datën 08.06.2022 dhe fillimi i punëve,
(i) Progresi	Viti 2023 karakterizohet me përfundimin e punëve ndërtimore, instaluese dhe testimit të pajisjeve elektrike në teren (SAT), trajnimi i personelit në terene, dhe
(ii) Rreziku dhe pengesat	Projekti është komisionuar nga komisioni për pranim i KOSTT-it me datën 04.05.2023 por nuk është energjizuar. Energjizimi i nënstacionit është i ndërlidhur me Projektin “Ndërtimi i linjës/kabllos 110kV për kyçje të nënstacionit të ri 110/35/10(20) kV Kastrioti LOT 5”.

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	ver. 1.2	faqe 70 nga 144
Departamenti: Financiar dhe i Thesarit		Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik

	<ul style="list-style-type: none"> Pagesat/Realizimet financiare: <p>Financiarisht projekti është përmbyllur në bazë të protokollit të punëve të kryera dhe sipas buxhetit, gjatë vitit 2023 janë realizuar 1,936,639.21 €</p> <p>(ii) Rreziku dhe Pengesat</p> <p>Mos përfundimi me kohë i projektit “Ndërtimi i linjës/kabllos 110kV për kyçje të nënstacionit të ri 110/35/10(20) kV Kastrioti LOT 5”, për shkak të pezullimit nga MMPHI si rezultat i disa ankesave në gjykatë nga pronarët e tokave dhe pritet të përfundohet gjatë 2024, atëherë do të realizohet edhe energjizimi i nënstacionit</p>
--	--

2.	Ndërtimi i linjës/kabllos 110kV për kyçje të nënstacionit të ri 110/35/10(20) kV Kastrioti LOT5
Buxheti	1,534,000€
Finacues	KOSTT
Vlera e Kontratës	1,166,590.40 €
Data e Fillimit	Maj 2021
Data e përfundimit	Maj 2023.
Kontraktues	Ukab .sh.p.k
Buxheti i shpenzuar total	203,025.00 €
Buxheti i Shpenzuar gjatë vitit 2023	00,00€
Statusi aktual i projektit	Pas marrjes së vendimit nga gjykata për paditë nga 2 pronarët e tokave, me datën 21.11.2023 është lëshuar leja e ndërtimit nga MMPHI
Realizimi:	(i) Progresi Është nënshkruar kontrata më 30.04.2021, ndërsa në 28.05.2021 është edhe fillimi efektiv i kontratës, Për shkakë të vonësës së marrjes së lejes për ndërtim me datën 15.05.2023 është bërë vazhdimi i kontratës deri më datën 29.05.2024, dhe
(i) Progresi	
(ii) Rreziku dhe pengesat	Me datën 21.11.2023 MMPHI ka lëshuar lejen e ndërtimit dhe kontraktori ka filluar përgatitjet për të punën dhe fillimin e punëve në teren. Projekti pritet të përfundoj në muajin maj 2024. (ii) Rreziku dhe Pengesat

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 71 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

	Vonesa në procesin gjygjësor me pronarët e tokave shkakton vonesa në shpronësim dhe marrjen e lejes ndërtimore, kjo ka shkaktuar vonesa në implementim të projektit që nënkupton në Energjizimin e Nënstacionit të ri NS 110/35/10(20)kV Ferizaji 3 (Kastriot) LOT1
--	---

3.	Ndërtimi i NS të ri GIS. 110/35/10(20) kV Fushë Kosova
Buxheti	4,950,000.00 €
Financues	KOSTT
Vlera e kontratës	3,849,199.19 €
Data e fillimit	Janar 2022
Data e përfundimit	Janar 2024
Kontraktues	Hitachi Power Grids Zagreb d.o.o.
Buxheti i shpenzuar total	2,567,270.44
Buxheti i shpenzuar gjatë 2023	1,989,890.56€
Statusi aktual i Projektit	Projektit aktualisht është duke u realizuar në kohë dhe brenda buxhetit. Konform protokollit të punëve, janë realizuar rreth 90% të punëve

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 72 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

<p>Realizimi:</p> <p>(i) Progresi</p> <p>(ii) Rreziku dhe pengesat</p>	<p>(i) Progresi</p> <p>Është nënshkruar kontrata më 14.12.2021, ndërsa me datën 13.01.2022 është paguar avansi dhe kjo është edhe fillimi efektiv i kontratës Nënstacioni NS. Fushë Kosova. Konform Ligjeve në fuqi, MMPHI me datën 23.01.2023 ka lëshuar lejen e “Ndërtimi i NS të ri GIS. 110/35/10(20) kV Fushë Kosova”</p> <p>Nga MMPHI për NS Fushë Kosova gjatë vitit 2023 janë mbajtur katër inspektime, ku raportet e inspektimit i bërë nga MMPHI</p> <p>Gjatë vitit 2023 janë realizuar të gjitha punët sipas kontratë dhe sipas protokollit të punëve janë realizuar deri në 90% e punëve. Pritet projekti të përfundon me kohë, në janar të vitit 2024</p> <p>Pagesat/Realizimet financiare:</p> <p>Gjatë vitit 2023, janë certifikuar dhe realizuar pagesat konform protokollit të punëve të kryera në vlerë prej 1,989,890.56€</p> <p>(ii) Rreziku dhe Pengesat</p> <p>Vonesat në procesin e prokurimit për furnizimin me transformator të fuqisë 40MVA Projekti “Furnizimi me TR1 40MVA NS Fushë Kosova “ ndikon në mos realizimin e një pjese të kontratës (që është në ndërlidhshmëri me transformatorin) si dhe në Energjizimin e Nënstacionit të ri GIS në Fushë Kosovë</p>
--	---

Emri projektit	Përgaditja e dokumentacionit ndërtimor projektues për NS 220/35/10(20) kV Malisheva
Buxheti	278,000€
Financues	KOSTT
Vlera e kontratës	153,341.00 €
Data e fillimit	30.08.2023
Data e përfundimit	30.04.2024
Kontraktues	PRO INTEGRIS d.o.o dhe ALB – Architect SH.P.K.
Buxheti i shpenzuar total	00,00€
Buxheti i shpenzuar gjatë - 2023	00,00€

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 73 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

Statusi aktual i Projektit	Projektit aktualisht është duke u realizuar në kohë dhe brenda buxhetit.
Realizimi:	(i) Progresi Me datën 30.08.2023 është nënshkruar kontrata ndërsa fillimi i shërbimeve në bazë të kontratës është 10 ditë nga data e nënshkrimit, data e fillimit 11.09.2023. Projekti duhet të përfundoj në prill të vitit 2024,
(i) Progresi	Gjatë vitit 2023 kontraktori ka punuar në dizajnim të nënstacionit dhe linjës të cilat janë aprovuar përmes DTS ,
(ii) Rreziku dhe pengesat	Gjatë kësaj periudhe janë marrë të gjitha pëlqimet parimore të kërkuara konform Ligjit, Nga MMPHI është marrë vendimi për debat publik i cili mbahet në shkurt të vitit 2024. Pagesat/Realizimet financiare: Gjatë vitit 2023 nuk është realizuar asnjë pagesë. (ii) Rreziku dhe Pengesat Vonesat në marrjen e lejeve ndërtimore, për shkak të procedurave për pëlqim mjedisor nga MMPHI

Realizimi i investimeve kapitale në nivel të KOSTT-it për vitin 2023 është si në vijim;

Të Planifikuara 10,423,116 € ndërsa të realizuara janë 4,915,919 € , të shprehura në përqindje 47%. Viti 2023 është ballafaquar me shumë pasiguri dhe rreziqet nga përmbarimet që ka ngjallur pasiguri nga aspekti financiar, gjë që ka shtyrë ndërmarrjen të ketë një çasje të kujdesshme ndaj investimeve kapitale.

- **Projektet e fazës së VI dhe VII – Financim nga Banka Gjermane për Zhvillim KfW të realizimit të projekteve.**

Sipas planit investues ky grup i projekteve është planifikuar të financohet me huamarrja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës, KfW (Kreditanstalt für Wiederaufbau) dhe KOSTT në kuadër të bashkëpunimit ndërshtetror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës Federale të Gjermanisë. Pas shumë konsultave dhe angazhimeve në fund të dhjetorit 2022 është realizuar nënshkrimi i marrëveshjes për kredi me KfW në vlerë prej 25,5Mil Euro. Gjatë vitit 2023, është pritur ratifikimi i kredisë nga Kuvendi i Kosovës i cili është realizuar në tetor 2023, është punuar në përgatitjen e Termave të Referencës (ToR) për shërbimet konsulentë paket projektet e planifikuar me KfW sipas planit të ri tarifor investiv 2023-2027 të aprovuara nga ZRrE janë si më poshtë :

a. Shërbimet konsulentë për përgatitjen e tender dosjes dhe mbikëqyrje te realizimit të projekteve;

b. LOT 1 : Furnizimi dhe ndërtimi

- “Ndërtimi i NS 110/10(20) kV-Dragashi” me transformatorë 1x40MVA dhe
- Shunt Reaktor 100 MVar në NS Ferizaj2.

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 74 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

c. LOT 2 SCADA dhe Telekom

- Furnizimi dhe instalimi I pajisjeve për adaptimin e SCADA (RTU & SCS);
- Ndërrimi i sistemit ekzistues SCADA/EMS për Qendrën Nacionale Dispeçerike dhe Emergjente Qendrën Dispeçerike; dhe
- Migrimi dhe avansimi I sistemit të telekomit .

d. LOT 3:Furnizimi dhe instalimi me transformatorë të fuqisë 40MVA;

- Furnizimi me transformer të fuqisë 110/10(20) kV in SS. Fushe Kosova;
- Furnizimi me transformer të fuqisë në NS 110/10(20) kV në NS. Ferizaj 3- Kastrioti;
- Ndërrimi i transformatorit të fuqisë në NS. Gjakova 1 , 110/10(20)/35 kV;
- Ndërrimi i transformatorit të fuqisë në NS. Theranda, 110/10(20) kV;
- Ndërrimi i transformatorit të fuqisë në NS Prizren 1, 110/10(20)/35 kV;
- Ndërrimi i transformatorit të fuqisë në NSPeja ,110/10(20)/35 kV;
- Ndërrimi i transformatorit të fuqisë në NS Ferizaj 110/10(20)/35 kV; dhe
- Ndërrimi i transformatorit të fuqisë në NS Decan ,, 110/10(20) kV.

e. LOT 4: Linjat transmetuese Kredi / Grant (WBIF) :

Linja ajrore /kabllore e re e dyfishtë dhe demontimi i linjë ekzistuese në mes të NS Prizreni 1 dhe NS Prizreni 2;

- Linja e re kabllore nëntokësore e njëfishtë në mes të NS Prishtina 4 dhe NS Prishtina 2, me gjatësi rreth 5km, 1000mm²;
- Revitalizimi i linjës 110kV NS Prizren 1 - Prizren 3;
- Fusha e re e linjës 110kV në NS Prizreni 1;
- Linja e dyfishtë ajrore 110kV NS. Dragash - Zhur (fundi i linjës së dyfishtë), vetëm me një përques (Kredi);
- Linja e re e njëfisht ajrore Zhur – NS Prizren 2 (Kredi);
- Linja e re ajrore 110kV NS Dragash sustation (conductor) - Kukes (kufi me Shqipërinë) (GRANT);
- Linja e re e njëfisht kabllore 110 kV NS Prishtina 4- NS Prishtina 2, me gjatësi totale përafërsisht 5 km, 1000mm² (GRANT).

Gjatë vitit 2023 me përkrahje e KfW-së, për zbutjen e financimit nga buxheti i KOSTTit për fazën e VII të KfW, kemi aplikuar të fonde grant në WBIF (Western Balkans Investment Framework) për linja 110kV, që pritet për aprovim.

Vlera totale e projekteve të planifikuara në fazën e VII KfW/KOSTT dhe WBIF është 40,062,500.00€, ku KfW/kredi do të financoj me 63,6% ndërsa WBIF përafërsisht me 22,3% e KOSTT me 14,1%.

Gjatë vitit 2022/2023 është Aplikuar për fondin IPA 2023 (Instrument for Pre-Accession Assistance) në EU për Grant për projektin :

- Ri-vitalizimi dhe përforsimi i segmentit të linjës 110 kV NS Kosova A-NS Bardhi-NS Ilirida-Vallaq

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 75 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

Projekti është përzgjedhur për financim nga EU si donacion në vlerë prej 11,5 mil €. Për projektin në fjalë është përgaditur Kost Benefit Analiza (KBA), është përgaditë Specifikimi Teknik nga ana e KOSTT . EU ka konfirmuar se fondin e ndarë për grant si dhe projektin do ta menaxhoj KfW në kuadër të projekteve të fazës së VII.

- **Me nënshkrimin e marrëveshjes në mes të Qeverisë dhe MCC për projekt në vlerë prej prej 236.7 Milion Dollar**, pjesëmarrja dhe kontributi i KOSTT-it ka qenë prezenent përmesë pjesëmarrjes në grupin punues qeveritar në procesin e zhvillimit të programit të marrëveshjes së financimit më
 - Vazhdimësinë e aktiviteteve të ndryshme lidhur me lokacionin për ndërtimin e baterisë së KOSTT-it;
 - Takimet e rregullta javore me MCC-Zyra e Kryeministrit, për plotesimin e parakushteve për inicimin e mjeteve të Kompakt.

Projekti është në zhvillim në fazën parapërgaditore, dhe pritet që të përfundoj në vitin 2028.

Viti 2023 rezulton me finalizimin dhe nënshkrimin e dy Marrëveshjeve të Kycjes për të cilat procedura (aplikim, oferta dhe Draft arrëveshja e Kycjes) janë zhvilluar në vitet e mëherëshme. Kapaciteti total për Energji me Erë është 97,2MW. Në formë tabelare janë paraqitur kompanitë nënshkruese të Marrëveshjeve të Kycjes :

Tabela 14. Kompanitë nënshkruese të Marrëveshjeve të Kycjes

Nr.	Emri i Aplikuesit	Kapaciteti i kycjes në MW	Lloji i gjeneratorit	Vendi i Kycjes	Data e Aplikimit	Oferta për Kycje	Nënshkrimi i Marrëveshjes së Kycjes
1	Data System L.L.C.-Energy Division "Mareci"	32.4	Erë	Në linjen NS Prishtina 4 - NS Gjilan 1	03.04.2018	13.06.2018	17.08.2023
2	EV WIND PARK Sh.p.k. "Zatriqi"	64.8	Erë	Rahovec	18.10.2017	04.04.2018	31.10.2023

Bazuar në Strategjinë e Energjisë 2023-2032 për energjinë e ripërtrishme edhe intresimi për kyçje në rrjetin e transmetimit gjatë vitit 2023 ka qenë në rritje, kjo paraqitet me numrin e aplikacioneve për kyçje në Rrjetin e Transmisionit, shqyrtimin e aplikacioneve dhe lëshimin e “informatave teknike“ bazuar në shkresën e dërguar nga ZRrE me 07.04.2021.

Gjatë vitit nga janari i vitit 2023 deri në dhjetor të vitit 2023 janë shqyrtuar dhe dhënë informatat teknike 20 aplikuesve me kapacitet total: Solare përafërsisht 2902,7 MW ndërsa me Erë 295,8MW (shih tabelën e mëposhtme) nëpër vende të ndryshme të Kosovës, por për rajonin e Klinës dhe atë të Gjakovës është interesimi më i madh:


	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	ver. 1.2	faqe 76 nga 144
Departamenti: Financiar dhe i Thesarit		Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik

Tabela 15. Aplikuesit e Energjisë së Ripërtrishme

Aplikuesit me Informatë teknike të Kyçjes viti 2023								
Nr.	Emri i Aplikuesit	Adresa e kompanisë	Personi përgjegjës	Vendi i Kyçjes dhe Komuna ku kërkohet kyçja	Data e Aplikimit	Lloji i gjeneratorit	Kapaciteti i kyçjes në MW	Informata teknike
1	ECO PARK GROUP SH.P.K	Madanaj rr. Qafa, p.n, Gjakovë	Lekë Sahatçiu	NS Peja 3, 110 kV - Pejë	17.01.2023	Solare	80	06.02.2023
2	Numac J.S.C.	Rr. Nëna Terezë, Zona Industriale, Prishtinë	Besnik Sadiku	Dy opsione: 220 kV Fierza, ose 110 kV Deçan-Gjakova 1	19.01.2023	Solare	30	15.02.2023
3	UNITED ENERGY Sh.p.k.	Rr. Hilmi Bajrami nr. 2, Prishtinë	Astri Shala	Linja 220 kV Malishevë-Prizren 2	02.02.2023	Solare	149.7	27.02.2023
4	Energy Sunday Park L.L.C.	Veranda,D4,Hyr.A,Kati I,Lagja Kalabria , p.n.	Liridon Ahmeti	NS Peja 3, 110 kV - Pejë	09.02.2023	Solare	100	27.02.2023
5	GREEN TECH ENERGY	Rruga Perandori Justinian, Sol 1/6, Prishtinë	Rico Koch	NS Drenasi-NS Prizren 2	14.02.2023	Solare	69	28.03.2023
6	Solar Tec 3 Sh.p.k.	Rr. Mehmet Gjevori, 67	Ardi Maraj	Linj interkonektive NS Prizren 2- NS Fierza	23.02.2023	Solare	70	17.03.2023
7	Rahoveci Solar Energy Park Sh.p.k.	Rruga Lord Bajron, 11 Prishtinë	Arben Gashi	Linja interkonektive 220 kV NS Drenasi-NS Prizren 2	01.03.2023	Erë	50	17.03.2023
8	Solariss L.L.C.	Rr. Pashko Vasa, kati VIII, Nr. 6, prishtinë	Lorik Haxhiu	Linja 400 kV NS Kosova B-NS Komani	02.03.2023	Solare	120	24.03.2023
9	Renewable Solutions Kosova L.L.C.	Rr. Haxhi Zeka, nr.39, Prishtinë	Faton Gashi	Linja NS Vitia -NS Gjilani 5	07.03.2023	Solare	100	24.03.2023
10	PRO Holdings SH.P.K.	Rruga Brigada 123, p.n., Suharekë	Dastid Ferati	Linja 220 kV NS Drenasi-NS Prizreni 2	07.03.2023	Solare	100	24.03.2023
11	WSC Wind and Solar Construction L.L.C	Nalban Cesme, Janjevë, Lipjan	Florin Imeri	Linja NS Kos B-NS Peja 3	28.03.2023	Erë / Solare	300	24.04.2023
12	Asnek Energy	Zona industriale Miradi e Eperme, Fushë KosovW	Albert Xhani	NS Peja 3, Zbarra 110 kV	03.04.2023	Solare	80	13.04.2023
13	Solar Tec 6 Sh.p.k.	Rr. Mehmet Gjevori, 67	Ardi Maraj	NS Peja 3- NS Peja 1	07.04.2023	Solare	110 MWp	25.05.2023
14	R50Kt Sh.p.k	Rr. Ismail Qemali, 150 Arbëri, Prishtinë	Arianit Zeqiri	NS Ferizaj 2, zbarra 110 kV	07.04.2023	Solare	150	25.04.2023
15	Alban Nishevci		Alban Nishevci	Linja 110 kV NS Prishtina 4-NS Gjilani 1	12.04.2023	Solare	30	27.04.2023

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	ver. 1.2	faqe 77 nga 144
Departamenti: Financiar dhe i Thesarit		Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik

Aplikuesit me Informatë teknike të Kyçjes viti 2023								
Nr.	Emri i Aplikuesit	Adresa e kompanisë	Personi përgjegjës	Vendi i Kyçjes dhe Komuna ku kërkohet kyçja	Data e Aplikimit	Lloji i gjeneratit	Kapaciteti i kyçjes në MW	Informata teknike
16	Solariss L.L.C.	Rr. Pashko Vasa, floor VIII, No. 6, Prishtinë	Lorik Haxhiu	NS Peja 3- NS Peja 1	14.04.2023	Solare	15	16.05.2023
17	POWER GREEN KOSOVA Sh.p.k.	Rr. Afrim Gashi 1, Landovicë, Prizren	Mehmet Gashi	NS Rahovec-NS Prizren 2 (opsioni 1) NS Drenas-NS Prizren 2 (opsioni 2)	18.04.2023	Solare	50	16.05.2023
18	PZDF SH.P.K.	Riza Selaci, p.n. Mitrovicë	Poema Zarari	Linja 220 kV NS Drenas-NS Prizren 2	18.05.2023	Solare	25	07.06.2023
19	Yildirim Energy Europe Kosovo Sh.p.k.	Besim Mala Street , No. 227, Glllogoc	Astri Shala	Në zbarren 220kV në NS Feronikeli 220/35 kV	26.06.2023	Solare	54.6	24.07.2023
20	Yildirim Energy Europe Kosovo Sh.p.k.	Besim Mala Street , No. 227, Glllogoc	Astri Shala	NS Lipjani 110/35/10kV	04.07.2023	Solare	65.21	28.07.2023
21	VLM SOLAR Sh.p.k.	Rruga Malet e Sharrit, p.n, Lipjan	Visar Bejta	NS Lipjani 110/35/10kV	10.07.2023	Solare	17	17.07.2023
22	TDI BALKANS Sh.p.k.	Rr. Mujo Ulqinaku, 8/3, Prishtinë	Iftach Ben Shlomo	NS Drenasi-NS Prizren 2	03.08.2023	Solare	45	28.08.2023
23	DUKAGJIN SOLAR TERSTENIK PE SH.P.K.	Rruga Ismail Qemali, Nr. 150, Prishtinë	Fadil Hoxha	njera linjë 110 kV, NS Peja 3- NS Peja 1	31.08.2023	Solare	96	04.10.2023
24	TDI BALKANS Sh.p.k.	Rr. Mujo Ulqinaku, 8/3, Prishtinë	Iftach Ben Shlomo	Linja 110 kV, NS Sharr-NS Ferizaj,	18.09.2023	Solare	55	04.10.2023
25	TDI BALKANS Sh.p.k.	Rr. Mujo Ulqinaku, 8/3, Prishtinë	Iftach Ben Shlomo	Opcioni 1: Linja 110 kV, NS Sharr-NS Ferizaj, reduktim nga 93.6 MW ne 70MW; Opcioni 2: ne NS Ferizaj 2	02.10.2023	Erë	93.6	20.10.2023
26	TDI BALKANS Sh.p.k.	Rr. Mujo Ulqinaku, 8/3, Prishtinë	Iftach Ben Shlomo	Kyçja në 220kV, LP NS KOS B -NS Besianë_ Bragash	31.10.2023	Erë	72	10.11.2023
27	German Plast Sh.p.k	Pn, Junik -Decan	Agron Krasniqi	Kyçja në 220kV, LP NS PZ 2 -NS Fierzë(Al) (Kom. e Gjakoves)	07.11.2023	Diell	200	30.11.2023
28	Solar Park Sh.p.k	Prishtinë - Simon Shiroka 29	Artakan Kuqani	Mirosal , Ferizaj	30.11.2023	Diell	68	04.01.2024

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 78 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

8.2. Perspektiva për vitin e ardhshëm

Në përputhje të plotë me rolin, misionin dhe vizionin, përpjekjet e KOSTT-it, edhe më tutje do të jenë të orientuara drejt realizimit të objektivave të saj strategjike të përcaktuara me Planin e Biznesit 2023-2027.

Zhvillimet kryesore nga aspekti i operimit të sistemit në KOSTT gjatë vitit 2024, do të jenë:

- Ngritja e cilësisë së Operimit të KOSTT si LFC Zonë në kuadër të LFC Bllokut AK, e krijuar nga KOSTT dhe OST e Shqipërisë;
- Nënshkrimin e marrëveshjeve të nevojshme si për RSC (Regional Security Coordination), EH (electronic highway), EAS (energy awareness system), VP (Verification Platform), OPC (outage planning coordination), SCC (Security critical coordination), STA (short-term generation adequacy), CGM\OPDE (operational planning data environment), Global NDA, etj.
- Operimi i KOSTT si Zonë Rregulluese/Bllok Rregullues më vete në përputhje me rregullat e ENTSO-E;
- Implementimi i Marrëveshjes për Rregullim Sekondar me OST dhe ndonjë tjetër POSH;
- Implementimi i marrëveshjeve ndër-OST me OST-të fqinje;
- Implementimi i Tregut Balancues sipas legjislacionit në fuqi;
- Operimi i tregut të liberalizuar në përputhje me ligjin e ri të energjisë elektrike;
- Pjesëmarrja e KOSTT-it në marrjen e shërbimeve s'paku nga një Qendër Koordinative Rajonale për Siguri (Regional Security Coordination);
- Investimi në platforma softuerike, që mundësojnë pjesëmarrje në operimin paralel interkonektiv në nivel pan evropian si SMTA (short & medium term generation adequacy), CGM\OPDE (operational planning data environment), RSC (regional security coordination), EAS (energy awareness system), OPC (outage planning coordination), SCC (Security critical coordination), dhe rifreskimi i atyre ekzistuese.
- Trajnimi dhe edukimi i stafit për përdorimin dhe shfrytëzimin e platformave softuerike për analiza të SCADA/EMS, Sistemit për Menaxhimin e Energjisë së Tregut, Kontrollit Frekuencë Fuqi-LFC, DACF- (Day Ahead Congestion Forecast - analiza e sigurisë së operimit një ditë para), IDCF (Intraday Congestion Forecast), paketi softuerik për mbikëqyrje dhe kontroll në kohën reale, pajisjeve të TL të tipit T 5000, E-TERRA Habitat,
- Avancimi i qendrës për leximin dhe menaxhimin e sistemeve matëse (AMR) për lehtësimin e kryerjes së aktiviteteve të të gjitha palëve pjesëmarrëse në tregun e energjisë, për të siguruar operim më eficient të sistemit të energjisë elektrike;
- Pjesëmarrja në procesin ENTSO-E të modelit vjetor 'Y-1'
- Zëvendësimi i infrastrukturës ekzistuese të sistemit SCADA/EMS konsiston në:
- Ngritjen e nivelit të realizimit të kontrollit në objektet e rrjetit të transmetimit nga Qendra Nacionale Dispečerike Kryesore dhe Emergjente;
- Përfshirja e të gjitha objekteve elektroenergjetike në kuadër të infrastrukturës së SCADA\EMS konform PZHT;
- Përfshirja e të gjitha ndryshimeve të realizuara në Nënstacione në SCS pas riparimeve dhe adaptimeve përkatëse;

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 79 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

- Përmbyllja e krijimit të kushteve teknike për monitorim të ndërsjellë me OST-të fqinje në kohën reale konform “Inter TSO Marrëveshjeve” me TSO-të e shteteve fqinje;
- Ndërlidhje e KOSTT në Electronic Highway (EH) të ENTSO-E si OST me drejta të plota me qëllim të shkëmbimit të të dhënave me ENSTO-E;
- Përgatitja e infrastrukturës teknike për qasje në platformën e EAS (Energy Awareness System) në kuadër të ENTSO-E.

Investimet në zhvillimin e infrastrukturës që mundësojnë proceset e mësipërme, janë:

- Qasja në “electronic highway –EH”
- Dërgimi i të dhënave në kohë reale në Qendrën Koordinative të Evropës Kontinentale-Swissgrid;
- Dërgimi i të dhënave dhe monitorimi i një pjese të sistemit të transmetimit për çështje të sigurisë së operimit të sistemit në KOSTT dhe të sistemeve tjera: OST, MEPSO, CGES dhe EMS sipas kërkesave të ENTSO-E;
- Shkëmbimi i të dhënave në fazën planifikuese me OST tjera përmes platformës softuerike SMTA, CGM\OPDE,OPC;
- Shkëmbimi i të dhënave në kohë reale me TSO Evropiane përmes platformës softuerike EAS;
- Shkëmbimi i të dhënave me Zonat Rregulluese fqinje dhe Qendrën Koordinative;
- Shkëmbimi i të dhënave me Qendrën Koordinative Rajonale për Siguri (Regional Security Coordination);
- Alokimi i kapaciteteve në baza vjetore, mujore, ditore me OST-të fqinje;
- Operacionalizimi dhe Shkëmbimi i të dhënave me ALPEX;
- Shkëmbimi i produkteve balancuese ndërkufitare;
- Zëvendësimi i sistemit ekzistues SCADA/EMS, për t’i plotësuar kërkesat e theksuara si më lartë.

8.2.1. Në kuadër të zhvillimeve kryesore nga aspekti i operimit të tregut, do të veçohen:

Liberalizimi i tregut dhe mundësitë e integritimit në tregun e përbashkët rajonal

Ndër sfidat kryesore me të cilat ballafaqohet sektori i energjisë elektrike në Kosovë është funksionimi i tregut efektiv konkurrues në sektorin e energjisë elektrike dhe integrimi në tregun e përbashkët rajonal.

Me miratimin e legjislacionit të ri të sektorit të energjisë elektrike në vitin 2016, Kosova ka nisur liberalizimin e tregut të energjisë që i hap rrugën thellimit të reformës në këtë sektor. Në këtë aspekt është përshtatur legjislacionin sekondar për tu harmonizuar me legjislacionin e ri. KOSTT ka rishikuar rregullat e tregut të cilat janë dërguar për miratim tek ZRRë dhe ka përpiluar procedurat e nevojshme për të mbështetur proceset në këtë drejtim.

Përkundër masave të ndërmarra drejt liberalizimit të tregut në Kosovë, deri tani mungon konkurrenca si në nivelin e tregut me shumicë po ashtu dhe atë me pakicë. Edhe pse ekzistojnë disa furnizues të licencuar për furnizim në tregun me pakicë të energjisë elektrike në Kosovë, tregu mbetet në nivel zhvillimi jo te knaqshem.

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 80 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

Aktualisht në tregun e energjisë elektrike janë vetëm pesë konsumatorë të parregulluar të cilët janë të kyçur në rrjetin e transmetimit (Ferronikeli i kyçur në nivelin 220kV, kurse SharriCemi, Trepça, PEE Selaci dhe PEE Kitka në nivelin 110kV), ndërsa të gjithë konsumatorët tjerë furnizohen me çmime të rregulluara dhe janë pjesë e grupit të konsumatorëve me të drejtë të shërbimit universal. Gradualisht sipas afateve të përcaktuara nga ZRrE edhe konsumatorët e kyçur në nivelin 35kV dhe 10kV duhet të furnizohen me çmim të parregulluar dhe nuk do të jenë konsumatorë me të drejtë të shërbimit universal.

Integrimi në tregun e përbashkët rajonal është mundësi e mirë për optimizimin dhe shfrytëzimin e burimeve më të lira të energjisë dhe pritet të japin efekte zbutëse sa i përket problemit të furnizimit, duke pasur parasysh që sistemi i transmetimit të Kosovës ka kapacitete të transmetimit interkonektiv të mjaftueshme që mundësojnë tregti ndërkufitare. Integrimet në tregjet rajonale janë obligim që kërkohet të përmbushet nga Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe njëra ndër objektivat kryesore të përcaktuara në Strategjinë e Energjisë së Republikës së Kosovës. Gjithashtu integrimi rajonal është ndër objektivat e rëndësishme të KOSTT-it që përkundër angazhimeve të vazhdueshme në këtë drejtim, edhe më tutje vazhdon të ballafaqohet me shumë pengesa drejt integrimit në mekanizmat rajonale.

8.2.2. Menaxhimi i procesit të Ndërrimit të Furnizuesit

Sipas Ligjit për Energjinë Elektrike të miratuar në vitin 2016, të drejtën e ndërrimit të Furnizuesit e ka çdo konsumator fundor, familjar ose jo familjar, ndërsa përgjegjësia për menaxhimin e procesit të ndërrimit të Furnizuesit i është dhënë Operatorit të Tregut. Këtë përgjegjësi Operatori i Tregut e ushtron sipas Rregullave të Tregut dhe Rregullës për Ndërrimin e Furnizuesit të miratuar nga ZRrE.

Në Udhëzuesin për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë të ZRrE-së të datës 18 janar 2017, janë përcaktuar edhe afatet kohore për de-rregullimin e çmimit të konsumatorëve fundorë. Bazuar në këtë udhëzim de-rregullimi i çmimit të konsumatorëve fundorë do të bëhet në mënyrë graduale duke përdorur qasjen më të përshtatshme të mundshme dhe atë bazuar në nivelin e tensionit në të cilin janë të kyçur konsumatorët dhe të drejtën për furnizim me energji elektrike në tregun konkurrues për të gjithë konsumatorët fundorë nga data e aprovimit të udhëzimit të ZRrE-së.

Bazuar në këto zhvillime te reja për mundësinë e konsumatorëve për ndërrimin e furnizuesit, KOSTT ka ndërmarrë dhe do të ndërmerr veprimet e nevojshme për menaxhimin e procesit ndërrimit të Furnizuesit, bazuar në Rregullat e Tregut dhe në afatet kohore të përcaktuara në udhëzuesin e ZRrE-së. Megjithatë duke pasur parasysh afatin kohor brenda të cilit duhet të përfundohet procesi i transferimit të konsumatorit dhe numrin e konsumatorëve që kanë të drejtën e ndërrimit të furnizuesit e që në të ardhmen ky numër pritet të rritet, atëherë KOSTT duhet të filloj përgatitjet për sigurimin e një softueri që ky proces të kryhet në mënyrë automatike dhe të jetë i auditueshëm.

KOSTT që nga dhjetori 2020 operon si Zonë e Pavarur Rregulluese në kuadër të Bllokut Rregullues. KOSTT ka arritur të shënojë përparime drejt integrimit në mekanizmat rajonale. Si rezultat i angazhimeve të vazhdueshme KOSTT është:

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 81 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

1. Nënshkruer i Marrëveshjes së Kycjes me ENTSO-E për punë paralele me Zonën Sinkrone të Evropës Kontinentale;
2. Themelues dhe aksionar i SEE CAO;
3. Pjesëmarrës në mekanizmin e pagesave dhe kompensimeve të transitit (ITC) në kuadër të ENTISOE;
4. Aksionar dhe bashkëthemelues i Bursës së Energjisë Elektrike (ALPEX) me Operatorin e Transmetimit të Shqipërisë.

Nënshkrimi i Marrëveshjes së kycjes me ENTISOE ka mundësuar që nga dhjetori 2020 KOSTT të ka mundësi që të alokojë kapacitetet e veta interkonektive përmes Zyrës për alokim të koordinuar të kapaciteteve. Hapja e Zyrës rajonale për alokim të koordinuar të kapaciteteve të transmetimit interkonektiv – CAO, do të lehtësojë dhe optimizojë procedurën e alokimit të kapaciteteve dhe vet procesin e shfrytëzimit të interkoneksionit. Vlen të theksohet se themelimi i kësaj Zyre është një hap drejt krijimit të tregut të përbashkët rajonal dhe integritit në tregun unik Evropian, dhe në anën tjetër, afron Kosovën në përmbushjen e obligimeve të marra në kuadër të Traktatit për Themelimin e Komunitetit të Energjisë dhe procesit të integritit në BE.

8.3. Sfidat e KOSTT

Sfidat për KOSTT, të cilat dalin nga Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës janë adresuar për arritjen e objektivit të integritit në tregun rajonal të energjisë, e që lidhen me:

- Operimi i suksesshëm i KOSTT-it si zonë rregulluese e pavarur në kuadër të Bllokut Rregullues Kosovë – Shqipëri (KS-AL) në kontest të balancimit të sistemit;
- Sigurimi i rezervave balancuese për sistemin, veçanërisht në kontest të integritit të BRE-ve,
- Mos mbulimi i kostove të furnizimit për pjesën veriore;
- Anëtarësimi në ENTSO-E në kontest të përmbushjes së obligimeve kontraktuale;
- Integritin në tregun rajonal dhe pan Evropian të energjisë ;
- Harmonizimi i bazës ligjore me direktivat e BE-së;

8.4. Aktivitetet tjera

Në përputhje me një nga objektivat strategjike të KOSTT, që të përkujdeset për shëndetin e punëtorëve, pas implementimit të Ligjit për sigurimet shëndetësore mendohet që të shkohet edhe me projekte tjera për mbrojtjen e punëtorëve në aspektin e shëndetit duke u bazuar në sigurimet tjera si në rast të aksidenteve personale për pjesën e punëtorëve të cilët punojnë në kushte të veçanta të punës.

Me qëllim të azhurnimit dhe harmonizimit të plotë të kërkesave, KOSTT ka implementuar me përpikëri të gjitha kërkesat e standardit ISO 9001:2015. , ISO 14001:2015 dhe ISO 45001:2018.

Në kuadër të Menaxhimit të cilësisë për qëllim të zhvillimit të vazhdueshëm të SIM KOSTT, në vitin 2021 është Ri-certifikuar për herë të 4 që nga viti 2010 me 3 Standarde të njohura ndërkombëtarisht dhe atë Standardin për menaxhimin e cilësisë ISO 9001:2015, standardin për Menaxhimin e mjedisit ISO 14001:2015 dhe standardin për Siguri dhe shëndet në punë ISO 45001:2018 si dhe për herë të parë është certifikuar me

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 82 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

Standardin për Menaxhimin e sigurisë së informacionit (ISMS) ISO 27001:2013 të cilat janë integruar në SIM (Sistemi i integruar i menaxhimit)

Këto Standarde janë implementuar me përpikëri gjithmonë duke pasur përmirësim të vazhdueshëm të sistemit të menaxhimit të cilësisë.

Në vazhdimësi të përkushtimit për ngritjen e cilësisë dhe ekselencës së biznesit në përputhje me standarde ndërkombëtare, KOSTT pas ri-certifikimit të vitit 2021, në vitin 2022 u realizua auditimi mbikëqyrës verifikues viti I (parë) pas ri-certifikimit, e gjithashtu edhe në vitin 2023 u realizua auditimi mbikëqyrës verifikues viti II (dytë) pas ri-certifikimit. Auditimi i realizua nga shtëpia certifikuese RoyalCert e cila edhe e ka bërë auditimin ri-certifikues në vitin 2021. Edhe me këtë auditimi mbikëqyrës verifikues u verifikua se Standardi ISO 9001, ISO 45001 dhe ISO 14001 në KOSTT mirëmbahen dhe zhvillohen në harmoni me kërkesat e standardeve. Kështu KOSTT bëhet kompania e vetme publike në Kosovë e ri-certifikuar për të katërtën herë me tri ISO standarde ndërkombëtare të cilësisë

KOSTT në vitin 2021 është certifikuar edhe me Standardin ndërkombëtar ISO 27001:2013 për Menaxhimin e Sigurisë së Informacionit (ISMS), ndërkaq në dhjetor të vitit 2022 u bë Auditimi mbikëqyrës verifikues për këtë Standard. Auditimi mbikëqyrës verifikues viti II (dytë) pas certifikimit për standardin 27001:2013 u realizua në dhjetor të vitit 2023 nga shtëpia certifikuese G-Certi e cila konstatoi se KOSTT i ka të përmbushura dhe zhvilluara të gjitha kërkesat e këtij standardi. Kështu KOSTT si kompani lidere në sektorin publik për zbatimin e standardeve ndërkombëtare të cilësisë, përmes këtij çertifikimi globalisht të njohur, dëshmoi angazhim serioz në zbatimin e praktikave më të mira ndërkombëtare në sigurinë e informacionit, mbrojtjen e konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së informacionit konform standardit ISO/IEC 27001:2013. Me këtë KOSTT edhe njëherë e konfirmon se është kompania e parë publike dhe kompania e parë në sektorin e energjisë në Kosovë e çertifikuar me standardin ndërkombëtar ISO/IEC 27001:2013, dhe gjithsejt e certifikuar me 4 ISO Standarde, duke e përmbyllur kështu vitin 2023 me një sukses që dëshmon vazhdimësi të ekselencës së biznesit.

Për të vazhduar me këtë gjegjësisht zhvillimet në fushën e Standardeve në vitin 2024 është planifikuar të bëhet Auditimi Ri-Certifikues në të njëjtën kohë për të gjitha ISO Standardet me të cilat KOSTT ka qenë e certifikuar deri tani dhe atë: ISO 9001:2015, ISO 14001:2015, ISO 45001:2018 si dhe me versionin e ri të vitit 2022 për Standardin ISO 27001. Të gjitha këtë Standarde do të integrohen në SIM (Sistemi i integruar i Menaxhimit) i cili aplikohet në KOSTT.

KOSTT në të ardhmen krahas zhvillimeve dhe kërkesave të reja planifikon certifikimin edhe me standarde tjera të cilat janë të nevojshme për kompaninë dhe të cilat gjithashtu do të integrohen në SIM së bashku me standardet tjera.

9. RREZIQET

Në afarizmin e KOSTT, kanë ndikim edhe rreziqet e mundshme, si pasojë e ndikimeve që vijnë nga jashtë, respektivisht nga rrethina afariste, dhe si të tilla, kanë implikimet e tyre në veprimtarinë e KOSTT.


	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 83 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

Në vazhdim janë analizuar dhe identifikuar disa nga këto rreziqe:

- Obstruksionet e EMS dhe disa TSO-ve të tjera ndaj KOSTT-it në procesin e integrimi rajonale dhe mekanizmat tjerë relevant ndërkombëtare;
- Zhvillimet globale si ndryshimet klimatike, pandemitë, konfliktet dhe krimet kibernetike;
- Dëmet e shkaktuara nga palët e treta në asetet e transmetimit, mungesa e sigurimit të aseteve të KOSTT-it;
- Ekspozimi ndaj rreziqeve të cilat rrjedhin nga kontestet gjyqësore;
- Vështirësitë e mundshme financiare nëse vazhdon të mos ketë furnizues për pjesën veriore të Kosovës;
- Procedurat e tej zgjatura të sigurimit të lejeve ndërtimore për ndërtimin e infrastrukturës së transmetimit;
- Risku rregullator në miratimin e tarifave që nuk reflektojnë koston reale;
- Mosfunksionimi i tregut të hapur dhe konkurrent të energjisë elektrike në rajon;
- Menaxhimi i Fondit të BRE-ve dhe llogarisë balancuese për shkak të riskut të mos pagesave nga palët;
- Mos implementimi i udhërrëfyesit aksional të nënshkruar nga Qeveria e Kosovës dhe e ajo e Serbisë;
- Vazhdimi i pamundësisë të alokimit të kapaciteteve transmetuese KOSTT-EMS për shkak të refuzimit të EMS; dhe
- Mundësia e kufizuar e rekrutimit të stafit profesional si pasojë e mungesës së ekspertëve.

Në mënyrë që të ulët ndikimi në secilin rrezik, janë të domosdoshme këto veprime:

- Krijimi i likuiditetit financiar në sektor në mënyrë që pagesat e detyrimeve të palëve të përfundojnë me kohë;
- Vazhdimi i aktiviteteve rreth evitimit të pengesave nga EMS në implementimin e plotë të marrëveshjes së kyçjes KOSTT-ENTSO-E;
- Mundësimi i transaksioneve tregtare në kufirin KOSTT-EMS. Kapacitetet e linjave Transmetuese në kufirin ndërmjet zonave të pavarura rregulluese KOSTT (Republika e Kosovës) – EMS (Republika e Serbisë) nuk alokohet për shfrytëzim komercial për shkak se pala serbe nuk ka nënshkruar marrëveshje interkonektive me KOSTT për alokimin e kapaciteteve transmetuese. Mungesa e këtij kapaciteti në treg shkakton kosto shtesë të shkëmbimeve ndërkufitare të energjisë elektrike në Kosovë dhe në regjion për shkak të paraqitjes së kongjestionëve;
- Vazhdimi i aktiviteteve rreth adresimit të furnizuesit për veriun e Kosovës;
- Anëtarësimi sa më shpejt që është i mundur në ENTSO-E;
- Avancimi i operimit të sistemit të transmetimit që i paraprinë me aftësinë e sistemit elektroenergjetik të akomodojë kërkesat e shfrytëzuesve të sistemit, duke ofruar shërbime të kualitetit të lartë, posaçërisht ndaj investitorëve privat të gjenerimit, furnizimit dhe shpërndarjes;
- Bashkëpunimi intensiv me palët e interesit duke sqaruar avantazhet e tregut të energjisë elektrike;

	RAPORTI VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 84 nga 144</i>
<i>Departamenti: Financiar dhe i Thesarit</i>		<i>Sektori: Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik</i>

- Fillimi i operimit të Bursës së energjisë elektrike Kosovë - Shqipëri (ALPEX); dhe
- Implementimi eficient i investimeve kapitale të KOSTT-it, duke përfshi edhe infrastrukturën për mbrojtjen nga sulmet kibernetike.

10. RAPORTI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Raporti përfshinë rezultatet e aktiviteteve audituese të kryera gjatë vitit 2023.

Aktivitetet audituese i kemi kryer sipas Ligjit për Ndërmarrjet Publike, manualit për auditim të brendshëm, procedurave dhe standardeve të cilat janë në funksion të auditimit të brendshëm, me qëllim garantimin e një efikasiteti sa më të lartë në funksion të optimizimit të vlerës në Ndërmarrje.

